FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 162

Tiranë – E enjte, 15 nëntor 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 71/2018 datë 18.10.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar.....	10997
Ligj nr. 72/2018 datë 18.10.2018	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr. 8850/2001, dhe Protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin nr. 8850/2001.....	11013
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 10724/4, datë 7.11.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë, faza I", shtesa.....	11029

LIGJ
Nr. 71/2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9902, DATË 17.4.2008, "PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, fjalia e dytë shfuqizohet dhe shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Zbatimi i dispozitave të këtij ligji nuk cenon zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë sektorët e veçantë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Dispozitat e këtij ligji zbatohen dhe për ato çështje që nuk rregullohen nga legjislacioni i posaçëm.".

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. "Garanci tregtare" është çdo zotim i tregtarit ose prodhuesit (garantuesit) ndaj konsumatorit, përveç detyrimit të tij ligjor lidhur me garantimin e përputhshmërisë, për të rimbursuar çmimin e paguar ose për të zëvendësuar, riparuar apo për t'u bërë shërbim mallrave, në çdo lloj mënyre, nëse ato nuk i plotësojnë specifikimet apo kërkesat e tjera, që nuk kanë të bëjnë me detyrimin ligjor të përputhshmërisë, të parashikuara në deklaratën e garancisë ose në publicitetin përkatës, të disponueshëm deri në kohën e lidhjes së kontratës.".

2. Në pikën 6, në pjesën e fundit të paragrafit, pas fjalës "tregtare" shtohen fjalët "biznesin, zanatin".

3. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

"7. "Mall për konsumatorët", më poshtë mall, është çdo send i luajtshëm, i trupëzuar, me përjashtim të sendeve që janë objekt i shitjes së detyrueshme apo të një forme tjetër të parashikuar me ligj. Uji, gazi dhe energjia do të konsiderohen si mallra, në kuptim të këtij ligji, kur vendosen në shitje në vëllim të kufizuar apo në një sasi të caktuar.".

4. Pas pikës 7 shtohet pika 7.1 me këtë përmbajtje:

"7.1 "Mallra të bëra sipas specifikimeve të konsumatorit" janë mallra të paparafabrikuara, të bëra në bazë të zgjedhjes personale apo vendimit të konsumatorit.".

5. Në pikën 14, pas fjalës "juridik" shtohen fjalët "privat ose publik".

6. Pas pikës 19 shtohen pikat 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 32 me këtë përmbajtje:

"20. "Kontratë shitjeje" është çdo kontratë, sipas së cilës tregtari kalon ose merr përsipër të kalojë pronësinë e mallrave te konsumatori, i cili paguan ose merr përsipër të paguajë çmimin e tyre. Objekt i kësaj kontrate janë mallrat dhe, sipas rastit, dhe shërbimet që i shoqërojnë ato.

21. "Kontratë shërbimi" është çdo kontratë e ndryshme nga një kontratë shitjeje, sipas së cilës tregtari furnizon ose merr përsipër të furnizojë një shërbim te konsumatori, i cili paguan ose merr përsipër të paguajë çmimin.

22. "Kontratë në largësi" është çdo kontratë e lidhur ndërmjet tregtarit dhe konsumatorit, sipas një skeme të organizuar shitjesh ose shërbimesh në largësi, pa praninë e njëkohshme fizike të tregtarit dhe të konsumatorit, me përdorimin ekskluziv të një apo më shumë mjeteve të komunikimit në largësi deri në çastin e lidhjes së kontratës, përfshirë dhe këtë çast.

23. "Kontratë jashtë qendrave të tregtimit" është çdo kontratë ndërmjet tregtarit dhe konsumatorit:

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht, me:
Direktivën 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 tetor 2011, "Mbi të drejtat e konsumatorit, e cila ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13/KEE dhe Direktivën 1999/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 85/577/KEE dhe Direktivën 97/7/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit", të ndryshuar. Numri CELEX 32011L0083, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 304, datë 22.11.2011, faqe 64–88.
Direktivën 2013/11/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 maj 2013, "Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve, e cila ndryshon Rregulloren (KE) nr. 2006/2004 dhe Direktivën 2009/22/KE", (Direktiva për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) konsumatore); numri CELEX: 32013L0011, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 165, datë 18.6.2013, f. 63–79.

a) E lidhur në praninë e njëkohshme fizike të tregtarit dhe konsumatorit, në një vend që nuk është qendra e tregtimit të tregtarit;

b) Për të cilën është bërë një ofertë nga konsumatori, në të njëjtat rrethana si ato të përmendura në shkronjën "a";

c) E lidhur në qendrën e tregtimit të tregtarit ose me anë të një mjeti komunikimi në largësi, menjëherë pasi konsumatori është adresuar personalisht dhe individualisht në një vend, i cili nuk është qendra e tregtimit të tregtarit, në praninë e njëkohshme fizike të tregtarit dhe të konsumatorit; ose

ç) E lidhur gjatë një ekskursioni të organizuar nga tregtari, me qëllim apo me pasojë promovimin dhe shitjen e mallrave apo shërbimeve të konsumatorit.

24. "Qendër tregtimi" është:

a) Çdo qendër shitjeje me pakicë, e paluajtshme, ku tregtari zhvillon aktivitetin e tij, në mënyrë të përhershme; ose

b) Çdo qendër shitjeje me pakicë, e luajtshme, ku tregtari kryen aktivitetin e tij zakonisht.

25. "Përmbajtje digjitale" janë të dhënat, të cilat prodhohen dhe jepen në formë digjitale.

26. "Shërbim financiar" është çdo shërbim me natyrë bankare, kredie, sigurimi, pensioni personal, investimi apo pagese.

27. "Ankand publik" është një procedurë shitjeje, ku mallrat apo shërbimet ofrohen nga tregtari te konsumatorët, të cilët marrin pjesë ose u jepet mundësia të marrin pjesë në ankand personalisht, përmes një procedure ankandi të hapur dhe konkurruese, të organizuar nga drejtuesi i ankandit dhe ku ofertuesi fitues është i detyruar t'i blejë mallrat apo shërbimet.

28. "Kontratë e ndërvarur" është një kontratë, me anë të së cilës konsumatori përfiton mallrat apo shërbimet nga një kontratë në largësi, ose një kontratë jashtë qendrave të tregtimit dhe ku ato mallra apo shërbime furnizohen nga tregtari, apo nga një i tretë, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet asaj pale të tretë dhe tregtarit.

29. "Mosmarrëveshje" është çdo mosmarrëveshje kontraktuale, ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit, që rrjedh nga një kontratë shitjeje ose shërbimi.

30. "Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjes (ZAM)" është tërësia e rregullave dhe procedurave, që shërben për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjes, në lidhje me detyrimet kontraktore që rrjedhin nga kontrata e shitjes ose shërbimit, ndërmjet një tregtari dhe një konsumatori, përmes ndërmjetësimit të një strukture për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, e cila propozon ose imponon një zgjidhje, ose i takon palët me njëra-tjetrën, me qëllim për të mundësuar gjetjen e një zgjidhjeje dhe që respekton kërkesat e parashikuara në këtë ligj.

31. "Struktura ZAM" është një strukturë e përhershme, përgjegjëse për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje përmes një procedure të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, sipas parashikimeve të këtij ligji.

32. "Ministria" është ministria përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit.".

Neni 3

Titulli i pjesës V ndryshohet si më poshtë:

"PJESA V, KUSHTET E PADREJTA NË KONTRATA DHE KONTRATA E SHITJES ME KONSUMATORËT"

Neni 4

Titulli i kreut II në pjesën V ndryshohet si më poshtë:

"KREU II, KONTRATA E SHITJES ME KONSUMATORËT"

Neni 5

Titulli i pjesës VI ndryshohet si më poshtë:

"PJESA VI, TË DREJTAT E KONSUMATORËVE DHE FORMAT E LIDHJES SË KONTRATËS ME KONSUMATORËT"

Neni 6

Titulli i kreut I në pjesën VI ndryshohet si më poshtë:

"KREU I, TË DREJTAT E KONSUMATORËVE NË KONTRATA"

Neni 7

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 34
Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e pjesës VI, të këtij ligji, zbatohen për çdo kontratë të lidhur, ndërmjet një tregtari dhe një konsumatori. Ato zbatohen edhe për kontratat

e furnizimit me ujë, gaz, energji apo për ngrohje lokale, përfshirë ato nga furnizuesit publikë, në rastin kur këto të mira ofrohen në bazë kontraktore.

2. Dispozitat e pjesës VI, të këtij ligji, nuk zbatohen në rastet kur parashikohet ndryshe në legjislacionin që rregullon sektorë të veçantë.

3. Për aspekte të përgjithshme të së drejtës së kontratave që nuk rregullohen nga ky ligj, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil mbi veprimet juridike dhe kontratat, në lidhje me rregullat për vlefshmërinë, krijimin apo efektin e një kontrate.

4. Dispozitat e pjesës VI, të këtij ligji, nuk pengojnë tregtarët që t'u ofrojnë konsumatorëve kushte kontraktore më të favorshme se ato të parashikuara nga dispozitat e këtij ligji.".

Neni 8

Pas nenit 34 shtohet neni 34/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 34/1

Përjashtimet

Përjashtohen nga fusha e zbatimit të dispozitave të pjesës VI, të këtij ligji, kontratat e mëposhtme:

a) Për shërbime sociale, duke përfshirë strehimin social, kujdesin për fëmijët dhe mbështetjen e familjeve dhe personave në nevojë, në mënyrë të përhershme apo të përkohshme, duke përfshirë kujdesin afatgjatë;

b) Për kujdesin shëndetësor, të dhënë nga profesionistët e shëndetit ndaj pacientëve, me qëllim vlerësimin, qëndrueshmërinë apo rivendosjen e gjendjes së tyre shëndetësore, përfshirë recetat, shpërndarjen dhe dhënien e barnave dhe pajisjeve mjekësore;

c) Për lojërat e fatit, përfshirë vënien e basteve me vlera monetare, lotaritë, lojërat në kazino dhe transaksionet e basteve;

ç) Për shërbimet financiare;

d) Për krijimin, fitimin apo transferimin e pronësisë mbi sendet e paluajtshme ose të të drejtave mbi sendet e paluajtshme;

dh) Për ndërtimin e ndërtesave të reja, transformimin në shkallë të konsiderueshme të ndërtesave ekzistuese dhe për dhënie strehimi me qira për qëllime banimi;

e) Për paketat e udhëtimit, të rregulluara nga pjesa VII, e kreut IV, të këtij ligji;

ë) Për përdorimin me afat të produktit të pushimit afatgjatë, të rishitjes dhe të shkëmbimit, të rregulluara nga pjesa VII, e kreut II, të këtij ligji;

f) Të lidhura përpara noterit apo ndonjë funksionari tjetër publik, i cili ka detyrimin ligjor për të qenë i pavarur e i paanshëm, dhe duke ofruar informacion të gjerë ligjor siguron që konsumatori lidh një kontratë, vetëm pas një shqyrtimi të kujdesshëm ligjor dhe pasi është njohur me pasojat juridike të saj;

g) Për furnizimin e produkteve ushqimore, pijeve ose mallrave të tjera, të caktuara për konsum të zakonshëm në familje dhe që furnizohen fizikisht nga një tregtar në vendin e banimit, të qëndrimit apo të punës së konsumatorit, në mënyrë periodike;

gj) Për shërbimin e transportit të pasagjerëve, me përjashtim të neneve 37, pika 2, dhe 37/11 e 37/14 të këtij ligji;

h) Të lidhura me anë të makinave automatike të shitjeve ose në njësi tregtare të automatizuara;

i) Të lidhura me operatorë telekomunikimi përmes telefonash publikë me pagesë për përdorimin e tyre, ose të lidhura për përdorimin e një lidhjeje të vetme me anë të telefonit, internetit ose faksit, të vendosura nga konsumatori.".

Neni 9

Pas nenit 34/1 shtohet kreu I/I me këtë përmbajtje:

"KREU I/I, INFORMACIONI PARA-KONTRAKTOR PËR KONSUMATORIN NË KONTRATA TË NDRYSHME NGA ATO TË LIDHURA NË LARGËSI APO JASHTË QENDRAVE TË TREGTIMIT"

Neni 10

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 35

Detyrimi për informacion në kontrata të ndryshme nga ato të lidhura në largësi apo jashtë qendrave të tregtimit

1. Përpara se konsumatori të ketë lidhur një kontratë të ndryshme nga një kontratë në largësi ose një kontratë jashtë qendrave të tregtimit apo të ketë pranuar ndonjë ofertë korresponduese, tregtari i jep konsumatorit informacionin e mëposhtëm, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme:

a) Karakteristikat kryesore të mallrave apo shërbimeve, në shkallën e përshtatshme për formën e komunikimit dhe për natyrën e mallrave apo shërbimeve;

b) Emrin e regjistruar të tregtarit, sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, adresën postare, në të cilën ai ushtron veprimtarinë tregtare dhe numrin e tij të telefonit;

c) Çmimin e plotë të mallrave apo të shërbimeve, përfshirë taksat apo tatimet, ose mënyrën me të cilën çmimi do të llogaritet, kur natyra e mallrave apo shërbimeve është e tillë që çmimi nuk mund të llogaritet paraprakisht për shkaqe të arsyeshme. Sipas rastit, jepet informacion mbi tarifat shtesë të transportit, të dorëzimit apo ato postare ose, kur këto tarifa, për shkaqe të arsyeshme, nuk mund të llogariten paraprakisht, për faktin që për tarifa të tilla shtesë mund të kërkohet pagesë;

ç) Parashikimet për mënyrën e pagesës, dorëzimin, ekzekutimin, kohën kur tregtari merr përsipër të dorëzojë mallrat apo të kryejë shërbimin, si dhe për procedurën e trajtimit të ankesave që ndjek tregtari, sipas rastit;

d) Kujtesën për ekzistencën e detyrimit ligjor të përputhshmërisë së mallrave, si dhe për ekzistencën dhe kushtet e shërbimeve pas shitjes e garancitë tregtare, sipas rastit;

dh) Afatin e kontratës, sipas rastit, ose, kushtet për zgjidhjen e kontratës, nëse kontrata ka afat të pacaktuar apo zgjatet automatikisht;

e) Funksionalitetin, përfshirë masat e zbatueshme të mbrojtjes teknike, të përmbajtjes digjitale, sipas rastit;

ë) Çdo ndërveprueshmëri përkatëse të përmbajtjes digjitale me *hardware* dhe *software*, për të cilat tregtari ka dijeni ose që duhet të ketë dijeni, sipas rastit.

2. Parashikimet e pikës 1, të këtij neni, zbatohen edhe për kontratat e furnizimit me ujë, gaz, apo energji elektrike, kur ato nuk janë vendosur në shitje në një vëllim të kufizuar apo sasi të përcaktuar, ngrohje lokale, ose përmbajtje digjitale, që nuk jepet në një mjet të trupëzuar.

3. Parashikimet e pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohen për kontrata që kanë të bëjnë me transaksione të përditshme dhe që përmbushen aty për aty, në kohën e lidhjes së kontratës.

4. Informacioni para lidhjes së kontratës, i kërkuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, vazhdon të zbatohet së bashku me parashikimet e pikës 1 të këtij neni.".

Neni 11

Titulli i kreut II në pjesën VI ndryshohet si më poshtë:

"KREU II, INFORMACIONI PËR KONSUMATORIN DHE E DREJTA E HEQJES DORË NGA KONTRATAT NË LARGËSI DHE KONTRATAT JASHTË QENDRAVE TË TREGTIMIT"

Neni 12

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 36

Detyrimi për informacion për kontratat në largësi dhe kontratat jashtë qendrave të tregtimit

1. Përpara se konsumatori të ketë lidhur një kontratë në largësi ose një kontratë jashtë qendrave të tregtimit apo të ketë pranuar ndonjë ofertë korresponduese, tregtari i jep konsumatorit informacionin e mëposhtëm, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme:

a) Karakteristikat kryesore të mallrave apo të shërbimeve, në shkallën e përshtatshme për formën e komunikimit dhe për natyrën e mallrave apo të shërbimeve;

b) Emrin e regjistruar të tregtarit, sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;

c) Adresën postare, në të cilën tregtari ushtron veprimtarinë, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të tregtarit, për t'i dhënë mundësi konsumatorit të kontaktojë tregtarin dhe të komunikojë me të, në mënyrë të shpejtë dhe efikase, si dhe adresën postare dhe emrin e regjistruar të tregtarit, sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, në emër të të cilit ai po vepron, sipas rastit;

ç) Adresën postare të qendrës së tregtarit, nëse është e ndryshme nga adresa e dhënë në përputhje me shkronjën "c", si dhe atë të tregtarit, në emër të të cilit ai vepron, sipas rastit, ku konsumatori mund të adresojë ndonjë ankesë;

d) Çmimin e plotë të mallrave apo të shërbimeve, përfshirë taksat e tatimet, ose mënyrën me të cilën çmimi do të llogaritet, kur natyra e mallrave apo shërbimeve është e tillë që çmimi nuk mund të llogaritet paraprakisht për shkaqe të arsyeshme. Sipas rastit, jepet edhe informacioni mbi të gjitha tarifat shtesë të transportit, të

dorëzimit apo ato postare dhe çdo kosto tjetër ose, kur këto tarifa, për shkaqe të arsyeshme, nuk mund të llogariten paraprakisht, për faktin që për tarifa të tilla shtesë mund të kërkohet pagesë.

Në rastin e një kontrate me afat të pacaktuar ose të një kontrate që përmban një abonim, çmimi i plotë përfshin koston e përgjithshme për periudhën e faturimit. Kur një kontratë e tillë ngarkohet me një çmim me tarifë fikse, çmimi i plotë përfshin edhe koston e përgjithshme mujore. Kur kostoja e përgjithshme, për shkaqe të arsyeshme nuk mund të llogaritet paraprakisht, jepet mënyra me të cilën do të llogaritet çmimi;

dh) Koston e përdorimit të mjeteve të komunikimit në largësi për lidhjen e kontratës, kur ajo kosto llogaritet me një tarifë të ndryshme nga ajo bazë;

e) Parashikimet për mënyrën e pagesës, dorëzimin, ekzekutimin, kohën kur tregtari merr përsipër të dorëzojë mallrat ose të kryejë shërbimet, si dhe për procedurën e trajtimit të ankesave që ndjek tregtari, sipas rastit;

ë) Kur ekziston e drejta e heqjes dorë nga kontrata, kushtet, afatin dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës në përputhje me pikën 1, të nenit 37/3, të këtij ligji, si edhe formularin model të heqjes dorë, të paraqitur në shtojcën I (B), bashkëlidhur këtij ligji;

f) Faktin që konsumatori duhet të përballojë koston e kthimit të mallrave, në rast të heqjes dorë nga kontrata, sipas rastit. Për kontratat në largësi, kur mallrat nga natyra e tyre nuk mund të kthehen normalisht me postë, duhet të jepet informacioni mbi koston e kthimit të tyre, sipas rastit;

g) Shpenzimet e arsyeshme që konsumatori detyrohet t'i paguajë tregtarit, sipas pikës 3, të nenit 37/6, të këtij ligji, nëse konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontrata pasi ka bërë një kërkesë, sipas neneve 36/5, pika 3, ose 37, pika 8, të këtij ligji;

gj) Informacionin që konsumatori nuk përfiton nga e drejta e heqjes dorë nga kontrata, në rastet kur kjo e drejtë, në përputhje me nenin 37/8, të këtij ligji, nuk është e parashikuar, ose rrethanat në të cilat konsumatori humbet të drejtën e tij të heqjes dorë nga kontrata, sipas rastit;

h) Kujtesën për ekzistencën e detyrimit ligjor të përputhshmërisë së mallrave, në përputhje me nenet 29–31 të këtij ligji;

i) Ekzistencën dhe kushtet për asistencë të klientëve pas shitjes, shërbime pas shitjes dhe garancitë tregtare, sipas rastit;

j) Ekzistencën e kodeve përkatëse të sjelljes, nëse tregtari ka marrë përsipër t'i bindet kodeve të tilla, si dhe mënyrën se si mund të merren kopje të tyre, sipas rastit;

k) Afatin e kontratës ose kushtet për zgjidhjen e kontratës kur kontrata është me afat të pacaktuar apo zgjatet automatikisht, sipas rastit;

l) Kohëzgjatjen minimale të detyrimeve të konsumatorit sipas kontratës, sipas rastit;

ll) Ekzistencën dhe kushtet e depozitave apo garancive të tjera financiare, që duhen paguar apo paraqitur nga konsumatori, me kërkesë të tregtarit, sipas rastit;

m) Funksionalitetin, duke përfshirë masat e zbatueshme të mbrojtjes teknike të përmbajtjes digjitale, sipas rastit;

n) Çdo ndërveprueshmëri përkatëse të përmbajtjes digjitale me *hardware* dhe *software*, për të cilat tregtari ka dijeni, ose që duhet të ketë dijeni, sipas rastit;

nj) Mundësinë e përdorimit të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve dhe të mekanizmit të vënies në vend të së drejtës, ku tregtari është subjekt, si dhe procedurat për përdorimin e saj, sipas rastit.

2. Parashikimet e pikës 1, të këtij neni, zbatohen, gjithashtu, për kontratat e furnizimit me ujë, gaz, apo energji elektrike, kur ato nuk janë vendosur në shitje në një vëllim të kufizuar apo sasi të përcaktuar, ngrohje lokale, ose përmbajtje digjitale, që nuk jepet në një mjet të trupëzuar.

3. Në rastin e një ankandi publik, informacioni i përmendur në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 1, të këtij neni, zëvendësohet me të dhëna të barasvlershme për organizuesin e ankandit.".

Neni 13

Pas nenit 36 shtohen nenet 36/1, 36/2, 36/3, 36/4 dhe 36/5 me këtë përmbajtje:

"Neni 36/1

Modeli i dhënies së informacionit

Informacioni i përmendur në shkronjat "ë", "f" dhe "g", të pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji, mund të jepet me anë të modelit të udhëzimeve për të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, paraqitur në shtojcën I (A), bashkëlidhur këtij ligji. Nëse tregtari

ia jep të plotësuara saktë këto udhëzime konsumatorit, ai ka përmbushur detyrimet për informacion, të kërkuara nga shkronjat "ë", "f" dhe "g", të pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji.

Neni 36/2
Efekti i informacionit të dhënë

Informacioni i parashikuar në pikën 1, të nenit 36, të këtij ligji, është pjesë përbërëse e një kontrate në largësi ose e një kontrate jashtë qendrave të tregtimit dhe nuk ndryshohet, përveçse kur palët kontraktuese bien dakord ndryshe shprehimisht.

Neni 36/3
Pasojat e mosdhënies së informacionit

Nëse tregtari nuk i ka përmbushur detyrimet për informacion mbi pagesën shtesë ose shpenzime të tjera, siç parashikohet në shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji, apo për koston e kthimit të mallrave, siç parashikohet në shkronjën "f", të pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji, atëherë konsumatori nuk detyrohet për këto pagesa apo shpenzime.

Neni 36/4
Barra e provës për dhënien e informacionit

Në rast mosmarrëveshjesh, tregtari ka detyrimin të provojë dhënien e informacionit të parashikuar në këtë kre.

Neni 36/5
Kërkesat formale për kontratat jashtë qendrave të tregtimit

1. Në kontratat jashtë qendrave të tregtimit, tregtari i jep konsumatorit informacionin e parashikuar në pikën 1, të nenit 36, të këtij ligji, me shkrim, ose, nëse konsumatori bie dakord, me anë të një mjeti tjetër të qëndrueshëm komunikimi. Informacioni duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm, i thjeshtë e i kuptueshëm.

2. Tregtari i jep konsumatorit një kopje të kontratës së nënshkruar ose konfirmimin e kontratës, me letër ose, kur konsumatori bie dakord, me anë të një mjeti tjetër të qëndrueshëm komunikimi, duke përfshirë, sipas rastit, konfirmimin paraprak të pëlqimit të shprehur dhe pranimin në përputhje me shkronjën "i", të nenit 37/8, të këtij ligji.

3. Kur një konsumator kërkon që kryerja e shërbimeve ose furnizimi me ujë, gaz apo energji elektrike, kur ato nuk vendosen në shitje në vëllim të kufizuar apo sasi të përcaktuar, apo ngrohja lokale, të fillojë gjatë periudhës të heqjes dorë nga kontrata, të parashikuar nga pika 2, e nenit 37/1, të këtij ligji, tregtari kërkon që konsumatori ta drejtojë një kërkesë të tillë me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi.".

Neni 14

Neni 37 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 37
Kërkesat formale për kontratat në largësi

1. Në kontratat në largësi, tregtari jep informacionin e parashikuar nga pika 1, e nenit 36, të këtij ligji, ose e vë këtë informacion në dispozicion për konsumatorin, në një mënyrë që përshtatet me mjetet e komunikimit në largësi, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Për sa kohë informacioni jepet me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, ky informacion duhet të jetë qartësisht i lexueshëm dhe i kuptueshëm.

2. Nëse një kontratë në largësi, e cila do të lidhet me mjete elektronike, e vendos konsumatorin nën detyrimin për të paguar, atëherë tregtari e vë në dijeni konsumatorin për informacionin e parashikuar nga shkronjat "a", "d", "k" dhe "l", të pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji, në mënyrë të qartë dhe të dukshme, menjëherë përpara se ai të bëjë porosinë.

Tregtari siguron që konsumatori, kur bën porosinë, të pranojë shprehimisht se porosia nënkupton një detyrim për të paguar. Nëse bërja e një porosie kërkon aktivizimin e një butoni apo një funksioni të ngjashëm, ky duhet të etiketohet në një mënyrë lehtësisht të lexueshme me fjalët "porosi me detyrim pagese", ose me një formulim tjetër të barasvlershëm, të qartë, ku të tregohet se bërja e porosisë nënkupton detyrimin për të paguar tregtarin. Nëse tregtari nuk vepron në përputhje me këtë përcaktim, konsumatorit nuk i lind asnjë detyrim nga kontrata ose porosia.

3. Faqet tregtare të internetit (*website*) duhet të vënë në dukje, në mënyrë të qartë dhe të lexueshme, që në fillim të procesit të bërjes së porosisë, nëse zbatohet ndonjë kufizim për dorëzimin e mallrave, si dhe mjetet e pagesës që pranohen për blerje.

4. Nëse kontrata lidhet me anë të një mjeti komunikimi në largësi, i cili lejon hapësirë apo kohë të kufizuar për të shfaqur informacionin, tregtari, përpara lidhjes së një kontrate të tillë, jep, të paktën, nëpërmjet këtij mjeti të caktuar, informacionin parakontraktor në lidhje me karakteristikat kryesore të mallrave apo shërbimeve, emrin e regjistruar të tregtarit, sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, çmimin e plotë, të drejtën për heqjen dorë nga kontrata, afatin e kontratës dhe kushtet për zgjidhjen e kontratës, nëse kontrata është me afat të pacaktuar, siç përcaktohet në shkronjat "a", "b", "d", "ë" dhe "k", të pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji. Informacioni tjetër, i parashikuar në pikën 1, të nenit 36, i jepet konsumatorit nga tregtari, në një mënyrë të përshtatshme, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni.

5. Nëse tregtari i telefonon konsumatorit, me qëllimin e lidhjes së kontratës në largësi, ai në fillim të bisedës bën të ditur identitetin e tij dhe, sipas rastit, identitetin e personit, në emër të të cilit ai po telefonon, si dhe qëllimin tregtar të telefonatës.

6. Kur një kontratë në largësi lidhet nëpërmjet telefonit, tregtari ia konfirmon ofertën konsumatorit, i cili detyrohet nga kontrata, vetëm pasi konsumatori ta ketë nënshkruar ofertën ose të ketë dërguar pëlqimin e tij me shkrim. Një konfirmim i tillë bëhet me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi.

7. Tregtari i jep konsumatorit konfirmimin e kontratës së lidhur, me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, brenda një kohe të arsyeshme pas lidhjes së kontratës në largësi, por jo më vonë se koha e dorëzimit të mallrave, ose përpara se të fillojë kryerja e shërbimit. Konfirmimi përfshin:

a) të gjithë informacionin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 36, të këtij ligji, përveçse kur tregtari ia ka siguruar ndërkohë këtë informacion konsumatorit, përpara lidhjes së kontratës në largësi, me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi; dhe

b) konfirmimin për pëlqimin e shprehur paraprakisht nga konsumatori për lidhjen e kontratës, si dhe konfirmimin e pranimit për humbjen e së drejtës së heqjes dorë nga kontrata, sipas parashikimeve të shkronjës "i", të nenit 37/8, të këtij ligji, sipas rastit.

8. Kur konsumatori dëshiron kryerjen e shërbimeve ose furnizimin me ujë, gaz, ose energji elektrike, kur ato nuk vendosen në shitje në vëllim të kufizuar apo sasi të përcaktuar, apo që ngrohja lokale të fillojë gjatë afatit së heqjes dorë nga kontrata, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 37/1, të këtij ligji, tregtari kërkon që konsumatori t'i drejtojë një kërkesë të shprehur.

9. Ky nen nuk cenon zbatimin e dispozitave për lidhjen e kontratës elektronike dhe tregtinë elektronike, parashikuar nga ligji nr. 10 128, datë 11.5.2009, "Për tregtinë elektronike".".

Neni 15

Pas nenit 37 shtohen nenet 37/1, 37/2, 37/3, 37/4, 37/5, 37/6, 37/7 dhe 37/8 me këtë përmbajtje:

"Neni 37/1

E drejta e heqjes dorë nga kontrata

1. Përveç rasteve kur zbatohen përjashtimet e parashikuara nga neni 37/8, i këtij ligji, konsumatori ka të drejtë të heqë dorë nga kontratat në largësi apo jashtë qendrave të tregtimit, brenda një afati prej 14 ditësh, pa dhënë ndonjë arsye dhe pa u detyruar për asnjë kosto tjetër, përveç atyre të parashikuara nga nenet 37/5, pika 2, dhe 37/6 të këtij ligji.

2. Pa cenuar zbatimin e nenit 37/2, të këtij ligji, afati i heqjes dorë nga kontrata, i përmendur në pikën 1, të këtij neni, përfundon pas 14 ditësh nga:

a) Dita e lidhjes së kontratës, në rastin e kontratave të shërbimit;

b) Dita në të cilën konsumatori ose një palë e tretë, e ndryshme nga transportuesi dhe e autorizuar nga konsumatori, merr në dorëzim mallrat, në rastin e kontratës së shitjes, ose:

i) Dita në të cilën konsumatori ose një palë e tretë, e ndryshme nga transportuesi dhe e autorizuar nga konsumatori, merr në dorëzim mallin e fundit, në rastin e disa lloje mallrash të porositura nga konsumatori në një porosi dhe të dorëzuara veç e veç;

ii) Dita në të cilën konsumatori apo një palë e tretë, e ndryshme nga transportuesi dhe e autorizuar nga konsumatori, merr në dorëzim lotin apo pjesën e fundit, në rastin e dorëzimit të mallit që përbëhet nga disa lote apo pjesë;

iii) Dita në të cilën konsumatori ose një palë e tretë, e ndryshme nga transportuesi dhe e autorizuar nga konsumatori, merr në dorëzim mallin e parë, në rastin e kontratës së furnizimit periodik të mallrave;

c) Dita e lidhjes së kontratës, në rastin e kontratave të furnizimit me ujë, gaz apo energji elektrike, kur ato nuk janë vendosur në shitje me një vëllim të kufizuar apo sasi të caktuar, ngrohje lokale, ose përmbajtje digjitale që nuk jepet në një mjet të trupëzuar.

3. Palët mund të përmbushin detyrimet kontraktore gjatë periudhës së heqjes dorë nga kontrata.

Neni 37/2

Mungesa e informacionit për të drejtën e heqjes dorë nga kontrata

1. Nëse tregtari nuk i ka siguruar konsumatorit informacionin për të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, siç kërkohet nga shkronja "ë", e pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji, afati i heqjes dorë përfundon 12 muaj nga mbarimi i afatit fillestar të heqjes dorë nga kontrata, parashikuar nga pika 2, e nenit 37/1, të këtij ligji.

2. Nëse tregtari i ka siguruar konsumatorit informacionin e parashikuar nga pika 1, e këtij neni, brenda 12 muajve nga dita e parashikuar në pikën 2, të nenit 37/1, të këtij ligji, afati i heqjes dorë nga kontrata përfundon 14 ditë pas ditës në të cilën konsumatori e merr atë informacion.

Neni 37/3

Ushtrimi i së drejtës së heqjes dorë nga kontrata

1. Konsumatori njofton tregtarin për vendimin e tij të heqjes dorë nga kontrata përpara plotësimit të afatit 14-ditor. Për këtë qëllim, konsumatori mund:

a) Të përdorë formularin model të heqjes dorë nga kontrata, sikurse parashikohet në shtojcën I (B) bashkëlidhur këtij ligji;

b) Të bëjë një deklaratë tjetër të qartë, ku të parashtrojë vendimin e tij të heqjes dorë nga kontrata.

2. Konsumatori duhet ta ketë ushtruar të drejtën e tij të heqjes dorë nga kontrata brenda afatit të parashikuar në nenet 37/1, pika 2, dhe 37/2, të këtij ligji, nëse njoftimin për ushtrimin e së drejtës së heqjes dorë nga kontrata e dërgon përpara plotësimit të atij afati.

3. Tregtari, përveç mundësive të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, mund t'i japë konsumatorit mundësinë që të plotësojë dhe të dorëzojë në mënyrë elektronike formularin model të heqjes dorë nga kontrata, parashikuar në shtojcën I (B) bashkëlidhur këtij ligji, ose çdo deklaratë tjetër të qartë në faqen e internetit (*website*) të tregtarit. Në këto raste, tregtari i konfirmon konsumatorit, pa vonesë, marrjen e njoftimit të heqjes dorë nga kontrata, në një mjet të qëndrueshëm komunikimi.

4. Konsumatori ka detyrimin të provojë ushtrimin e së drejtës së heqjes dorë nga kontrata, të parashikuar nga ky nen.

Neni 37/4

Efektet e së drejtës së heqjes dorë nga kontrata

Ushtrimi i së drejtës së heqjes dorë nga kontrata u jep fund detyrimeve të palëve:

a) për të përmbushur kontratën në largësi ose kontratën jashtë qendrave të tregtimit; ose

b) për të lidhur kontratën në largësi ose kontratën jashtë qendrave të tregtimit, në rastet kur është bërë një propozim nga konsumatori.

Neni 37/5

Detyrimet e tregtarit në rast të heqjes dorë nga kontrata

1. Tregtari i rimburson të gjitha pagesat e marra nga konsumatori, duke përfshirë, nëse është rasti, kostot e dorëzimit, pa vonesa të panevojshme, por jo më vonë se 14 ditë nga dita në të cilën ai është njoftuar për vendimin e konsumatorit për heqjen dorë nga kontrata, sipas nenit 37/3 të këtij ligji.

Tregtari kryen rimbursimin e përmendur më sipër, duke përdorur të njëjtin mjet pagese që konsumatori ka përdorur për transaksionin fillestar, përveç rasteve kur konsumatori ka rënë dakord shprehimisht ndryshe, me kusht që konsumatori të mos paguajë asnjë tarifë, si rezultat i një rimbursimi të tillë.

2. Pavarësisht nga pika 1, e këtij neni, tregtarit nuk do t'i kërkohet të rimbursojë kostot shtesë, nëse konsumatori ka zgjedhur shprehimisht një lloj tjetër dërgese, të ndryshme nga ajo standarde dhe më pak të kushtueshme, e ofruar nga tregtari.

3. Nëse tregtari nuk ka ofruar t'i tërheqë vetë mallrat, në rastin e kontratës së shitjes, ai mund të mos e bëjë rimbursimin derisa të ketë marrë në dorëzim mallrat ose derisa konsumatori të ketë paraqitur prova se i ka kthyer mallrat, cilado qoftë më e para.

Neni 37/6

Detyrimet e konsumatorit në rast të heqjes dorë nga kontrata

1. Përveç rastit kur tregtari është ofruar t'i tërheqë vetë mallrat, konsumatori i kthen mallrat ose ia dorëzon ato tregtarit apo një personi të autorizuar prej tregtarit për të marrë në dorëzim mallrat, pa vonesa të panevojshme, por jo më vonë se 14 ditë nga dita në të cilën ai ka njoftuar tregtarin për vendimin e heqjes dorë nga kontrata, sipas nenit 37/3 të këtij ligji. Ky afat konsiderohet i respektuar nëse konsumatori i kthen mallrat përpara se të ketë përfunduar afati prej 14 ditësh.

Konsumatori detyrohet vetëm për kostot e drejtpërdrejta të kthimit të mallrave, përveç rasteve kur tregtari ka pranuar t'i përballojë vetë ato ose kur tregtari nuk ka arritur të njoftojë konsumatorin se kostot detyrohet t'i paguajë vetë konsumatori.

Në rastin e kontratës jashtë qendrave të tregtimit, kur mallrat janë dorëzuar në banesën e konsumatorit në kohën e lidhjes së kontratës, tregtari, me shpenzimet e veta, detyrohet t'i tërheqë ato, nëse për shkak të natyrës së tyre, ato lloj mallrash nuk mund të kthehen normalisht me postë.

2. Konsumatori mban përgjegjësi vetëm për vlerën e pakësuar të mallrave që rezulton nga një përdorim i ndryshëm nga ai që nevojitet për të përcaktuar natyrën, karakteristikën dhe funksionimin e tyre. Megjithatë, konsumatori nuk është përgjegjës për vlerën e pakësuar të mallrave, në rastet kur tregtari nuk i ka dërguar konsumatorit njoftimin e së drejtës së heqjes dorë nga kontrata, sipas shkronjës "ë", të pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji.

3. Kur konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, pasi ka bërë një kërkesë, sipas neneve 36/5, pika 3, ose 37, pika 8, të këtij ligji, konsumatori i paguan tregtarit një shumë monetare në përpjesëtim me vlerën që ai ka dhënë, deri në kohën kur ka njoftuar tregtarin për ushtrimin e së drejtës së heqjes dorë nga kontrata, e krahasuar me përmbushjen e plotë të detyrimit kontraktor. Shuma përpjesëtimore që konsumatori duhet t'i paguajë tregtarit llogaritet në bazë të çmimit të plotë të pranuar në kontratë. Nëse ky çmim është tepër i lartë, kjo shumë llogaritet në bazë të vlerës së tregut të asaj që është dhënë.

4. Konsumatori nuk detyrohet për kostot e:

a) Kryerjes së shërbimeve ose furnizimin me ujë, gaz, ose energji elektrike, kur ato nuk vendosen në shitje në vëllim të kufizuar ose në sasi të përcaktuar, ose për ngrohje lokale, të plotë a të pjesshme, gjatë periudhës së heqjes dorë nga kontrata, kur:

i. tregtari nuk e ka informuar, sipas shkronjave "ë" dhe "g", të pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji; ose

ii. konsumatori nuk ka kërkuar shprehimisht që zbatimi i kontratës të nisë gjatë afatit të heqjes dorë nga kontrata, sipas neneve 36/5, pika 3, dhe 37, pika 8, të këtij ligji;

b) Furnizimit, të plotë a të pjesshëm, të përmbajtjes digjitale që nuk jepet në një mjet të trupëzuar kur:

i. konsumatori nuk ka dhënë ndonjë pëlqim të shprehur paraprakisht për fillimin e zbatimit të kontratës, përpara plotësimit të afatit 14-ditor, të parashikuar në nenin 37/1 të këtij ligji;

ii. konsumatori nuk ka pranuar se e humbet të drejtën e heqjes dorë nga kontrata kur ka dhënë pëlqimin; ose

iii. tregtari nuk ka dhënë konfirmimin e tij, sipas parashikimit të neneve 36/5, pika 2 ose 37, pika 7, të këtij ligji.

5. Përveç sa parashikohet në pikën 2, të nenit 37/5, të këtij ligji, dhe në këtë nen, konsumatorit nuk i lind asnjë detyrim tjetër si pasojë e ushtrimit të së drejtës së heqjes dorë nga kontrata.

Neni 37/7

Efektet e ushtrimit të së drejtës së heqjes dorë nga kontratat e ndërvarura

1. Pa cenuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë kredinë konsumatore, nëse konsumatori ushtron të drejtën e tij të heqjes dorë nga një kontratë në largësi ose një kontratë jashtë qendrave të tregtimit, sipas neneve 37/1 deri në 37/6, të këtij kreu, çdo kontratë e ndërvarur do të përfundojë automatikisht, pa ndonjë kosto për konsumatorin, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga nenet 37/5, pika 2, dhe 37/6 të këtij kreu.

2. Tregtari, kur njoftohet nga konsumatori për vendimin e tij të heqjes dorë nga kontrata, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, ka detyrim të informojë për këtë vendim çdo tregtar tjetër, të lidhur nga një kontratë e ndërvarur.

Neni 37/8
Përjashtime nga e drejta e heqjes dorë nga kontrata

Dispozitat e këtij kreu, që parashikojnë të drejtën e heqjes dorë nga kontratat në largësi dhe jashtë qendrave të tregtimit, sipas neneve 37/1 deri në 37/7, nuk zbatohen për sa u takon:

a) Kontratave të shërbimeve pasi shërbimi është kryer plotësisht, nëse zbatimi i kontratës ka filluar me pëlqimin e shprehur paraprak të konsumatorit dhe me pranimin se ai do të humbasë të drejtën e tij të heqjes dorë nga kontrata, sapo kontrata të jetë ekzekutuar plotësisht nga tregtari;

b) Furnizimit të mallrave apo shërbimeve, për të cilat çmimi varet nga luhatjet në tregun financiar, të cilat nuk mund të kontrollohen nga tregtari dhe që mund të ndodhin brenda afatit të heqjes dorë nga kontrata;

c) Furnizimit të mallrave të bëra sipas specifikimeve të konsumatorit ose që janë qartësisht të personalizuara;

ç) Furnizimit të mallrave, të cilat janë të rrezikuara të prishen ose të skadojnë me shpejtësi;

d) Furnizimit të mallrave të vulosura, të cilat nuk janë të përshtatshme për t'u kthyer, për arsye të mbrojtjes së shëndetit apo të higjienës dhe që janë hapur pas dorëzimit;

dh) Furnizimit të mallrave, të cilat, pas dorëzimit, për shkak të natyrës së tyre, janë përzier në mënyrë të pandashme me artikuj të tjerë;

e) Furnizimit të pijeve alkoolike, vlera aktuale e të cilave varet nga luhatjet në treg dhe nuk mund të kontrollohet nga tregtari, por që për çmimin është rënë dakord në kohën e lidhjes së kontratës së shitjes dhe dorëzimi mund të bëhet vetëm pas 30 ditëve;

ë) Kontratave, ku konsumatori ka kërkuar specifikisht një vizitë nga tregtari, me qëllim kryerjen e riparimeve urgjente ose mirëmbajtjes. Nëse, në rastin e një vizite të tillë, tregtari ofron shërbime të tjera, veç atyre që ka kërkuar në mënyrë specifike konsumatori, ose mallra të tjera, përveç pjesëve të këmbimit, të nevojshme për t'u përdorur gjatë mirëmbajtjes apo kryerjes së riparimeve, e drejta e heqjes dorë nga kontrata ushtrohet për këto shërbime ose mallra shtesë;

f) Furnizimit të regjistrimeve audio ose video të vulosura apo *software* kompjuterash të vulosur, që janë hapur pas dorëzimit;

g) Furnizimit të një gazete, periodiku apo reviste, me përjashtim të kontratave të abonimit për furnizimin e botimeve të tilla;

gj) Kontratave të lidhura në një ankand publik;

h) Ofrimit të strehimit për qëllime të tjera nga ato për banim, transportit të mallrave, shërbimeve të dhënies me qira të makinave, kateringut ose shërbimeve të lidhura me aktivitete të kohës së lirë, nëse kontrata parashikon një datë specifike ose një periudhë të caktuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj;

i) Furnizimit të përmbajtjes digjitale që nuk jepet në një mjet të trupëzuar, kur ekzekutimi ka nisur me pëlqimin e shprehur paraprakisht të konsumatorit dhe pranimit nga ana e tij se në këtë mënyrë ai humbet të drejtën e heqjes dorë nga kontrata.".

Neni 16

Pas nenit 37/8 shtohet kreu III me këtë përmbajtje:

"KREU III
TË DREJTA TË TJERA TË KONSUMATORIT

Neni 37/9
Fusha e zbatimit

1. Nenet 37/10 dhe 37/12, të këtij kreu, zbatohen për kontratat e shitjes. Këto nene nuk zbatohen për kontratat e furnizimit me ujë, gaz apo energji elektrike, kur ato nuk vendosen në shitje në vëllim të kufizuar apo sasi të caktuar, ngrohje lokale, ose furnizimin me përmbajtje digjitale që nuk jepet në një mjet të trupëzuar.

2. Nenet 37/11, 37/13 dhe 37/14, të këtij kreu, zbatohen për kontratat e shitjes e shërbimeve dhe kontratave për furnizimin me ujë, gaz, energji, ngrohje lokale apo përmbajtje digjitale.

Neni 37/10
Dorëzimi

1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe në kohën e dorëzimit, tregtari i dorëzon mallrat përmes transferimit të posedimit fizik ose kontrollit të mallrave te konsumatori, pa vonesa të panevojshme, por jo më vonë se 30 ditë nga lidhja e kontratës.

2. Kur tregtari nuk ka arritur të përmbushë detyrimin e tij për të dorëzuar mallrat në kohën e rënë dakord me konsumatorin ose brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, konsumatori e

njofton tregtarin ta bëjë dorëzimin brenda një afati shtesë, që t'i përshtatet rrethanave. Nëse tregtari nuk arrin të dorëzojë mallrat brenda afatit shtesë, konsumatori ka të drejtë të zgjidhë kontratën.

Në rastet kur tregtari ka refuzuar të dorëzojë mallrat ose kur dorëzimi brenda afatit të dorëzimit të pranuar është thelbësor, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lidhjes së kontratës, ose kur konsumatori e njofton tregtarin, përpara lidhjes së kontratës, se dorëzimi deri në, ose në datën e specifikuar është thelbësor, e megjithatë tregtari nuk arrin të dorëzojë mallrat në kohën e rënë dakord me konsumatorin, apo brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, konsumatori ka të drejtë të zgjidhë menjëherë kontratën.

3. Me zgjidhjen e kontratës, tregtari rimburson, pa vonesa të panevojshme, të gjitha shumat e paguara në bazë të kontratës.

4. Përveç zgjidhjes së kontratës, në përputhje me pikën 2, të këtij neni, konsumatori ka të drejtë të përdorë edhe mjetet juridike që ka në dispozicion, në rastin e mospërmbushjes së detyrimeve, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 37/11
Tarifat për përdorimin e mjeteve të pagesës

Tregtarët ndalohen t'u ngarkojnë konsumatorëve tarifa, në lidhje me përdorimin e një mjeti të caktuar pagese, të cilat e tejkalojnë koston e përballuar nga tregtari për përdorimin e mjeteve të tilla.

Neni 37/12
Kalimi i rrezikut të humbjes ose dëmtimit të mallrave

Në kontratat ku tregtari i dërgon mallrat te konsumatori, rreziku i humbjes ose i dëmtimit të mallrave kalon te konsumatori kur ai ose një palë e tretë, e autorizuar nga konsumatori, por e ndryshme nga pala transportuese, ka fituar posedimin e mallrave. Me dorëzimin te transportuesi, nëse transportuesi është porositur nga konsumatori për të transportuar mallrat dhe nëse ajo zgjedhje nuk është ofruar nga tregtari, risku i kalon konsumatorit, pa cenuar të drejtat e konsumatorit përkundrejt transportuesit.

Neni 37/13
Komunikimi me telefon

Në rast se tregtari operon një linjë telefonike, me qëllim për ta kontaktuar konsumatorin me telefon për kontratën e lidhur, atëherë konsumatori kur telefonon tregtarin nuk paguan më shumë se tarifa bazë. Ky përcaktim nuk cenon të drejtën që kanë ofruesit e shërbimit të telekomunikacionit për të faturuar thirrje të tilla ndaj tregtarëve.

Neni 37/14
Pagesa shtesë

Përpara se konsumatorit t'i lindin detyrime nga kontrata ose oferta, tregtari kërkon pëlqimin e shprehur të konsumatorit për çdo pagesë shtesë, përveç çmimit të rënë dakord për detyrimin kryesor kontraktor të tregtarit. Nëse tregtari nuk ka marrë pëlqimin e shprehur të konsumatorit, por e ka nënkuptuar atë, duke përdorur opsionet e paracaktuara, të cilat i kërkohen konsumatorit t'i refuzojë për të shmangur pagesën shtesë, konsumatori ka të drejtë të rimbursohet për këtë pagesë.

Neni 37/15

Çdo kusht kontraktor, i cili drejtpërdrejt apo jodrejtpërdrejt, heq ose kufizon të drejtat e parashikuara nga pjesa VI, e këtij ligji, është i pavlefshëm dhe nuk krijon efekte juridike për konsumatorin.".

Neni 17

Në nenin 38, pika 1, pas fjalës "mallra" shtohen fjalët "ujë, gaz, energji, ngrohje lokale ose përmbajtje digjitale" dhe pas fjalës "shërbime" shtohen fjalët "të ndaluara, sipas pikës 7, të nenit 17, seksioni B, të këtij ligji".

Neni 18

Në nenin 51, pika 1, në fund të fjalisë, pas referencës në nenin "18" hiqen nenet "19, 20, 21" dhe shtohen "31, 32 dhe 33".

Neni 19

Në nenin 52 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Pas pikës 8 shtohen pikat 9, 10 dhe 11 me këtë përmbajtje:

"9. Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve është autoriteti kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të neneve 52/3 deri 52/5, të këtij ligji, nga strukturat ZAM përgjegjëse, të përcaktuara në nenet 52/2 dhe 52/6 të tij. Komisioni publikon në faqen e tij zyrtare të internetit listën e strukturave të ZAM-it, të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara sipas këtyre dispozitave.

10. Në ushtrimin e funksioneve të tij, sipas përcaktimit të pikës 9, të këtij neni, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve merr, sa herë e konsideron të nevojshme dhe në çdo rast jo më pak se një herë në fund të çdo viti kalendarik, nga secila strukturë ZAM përgjegjëse, sipas përcaktimit të neneve 52/2 dhe 52/6, të këtij ligji, raportin vjetor të aktivitetit, i cili përfshin të paktën informacion për:

a) Numrin e mosmarrëveshjeve të paraqitura dhe llojet e ankesave me të cilat ato lidhen;

b) Çdo problem sistematik ose të rëndësishëm që ndodh shpesh dhe që shpie në mosmarrëveshje, ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve, përfshirë rekomandime në lidhje me mënyrën se si mund të shmangen probleme të tilla ose zgjidhjen në kohë të tyre, kur është e mundur;

c) Shkallën e mosmarrëveshjeve që struktura ZAM ka refuzuar të trajtojë dhe përqindjen e llojeve të shkaqeve për këto refuzime, siç përcaktohet në nenin 52/4 të këtij ligji;

ç) Përqindjen e zgjidhjeve të propozuara ose të detyrueshme në favor të konsumatorëve dhe në favor të tregtarëve dhe mosmarrëveshjet e zgjidhura me anë të një zgjidhjeje miqësore;

d) Përqindjen e procedurave të ZAM-it që janë ndërprerë dhe kur dihen arsyet e ndërprerjes;

dh) Kohëzgjatjen mesatare të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;

e) Shkallën e pranimit, nëse dihet, të rezultateve të procedurave të ZAM-it.

11. Raporti vjetor i aktivitetit të strukturës ZAM bëhet publik në faqen e saj të internetit përmes një mjeti komunikimi të qëndrueshëm, sipas kërkesës dhe në çdo mënyrë tjetër që struktura e konsideron të përshtatshme.".

Neni 20

Pas nenit 52/1 shtohen nenet 52/2, 52/3, 52/4, 52/5 dhe 52/6 me këtë përmbajtje:

"Neni 52/2

Struktura përgjegjëse ZAM mbi shërbimet me interes publik

1. Struktura ZAM ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit mbi shërbimet me interes publik, sipas përcaktimit të shkronjës "dh", të pikës 1, të nenit 56, të këtij ligji, janë si më poshtë:

a) Për veprimtaritë në fushën e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, funksionet e ZAM-it me konsumatorin kryhen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror";

b) Për veprimtaritë në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, funksionet e ZAM-it me konsumatorin kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë";

c) Për veprimtaritë në fushën e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, funksionet e ZAM-it me konsumatorin kryhen nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU), në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar;

ç) Për veprimtaritë në fushën e sigurimit dhe risigurimit, funksionet e ZAM-it me konsumatorin kryhen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në zbatim të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të ndryshuar, si dhe nga strukturat e përcaktuara në ligjin nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit";

d) Për veprimtaritë në fushën e aviacionit civil, funksionet e ZAM-it me konsumatorin kryhen nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në zbatim të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 10 233, datë 11.2.2010, "Për Autoritetin e Aviacionit Civil".

2. Struktura e ZAM-it ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit për shërbimet financiare bankare, si dhe organizimi e funksionimi i tij përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm që rregullon këto shërbime.

Neni 52/3

Kërkesat e përgjithshme për ushtrimin e funksioneve ZAM mbi shërbimet me interes publik

1. Struktura e ZAM-it, sipas përcaktimit të nenit 52/2, të këtij ligji, me qëllim regjistrimin dhe trajtimin e mosmarrëveshjeve të konsumatorit me tregtarin në fushat e tyre të veprimtarisë sigurojnë:

a) Krijimin dhe përditësimin e një faqeje interneti, që u ofron lehtësisht palëve

informacionin e nevojshëm për procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si dhe dhënien e këtij informacioni, me kërkesën e palëve, përmes një mjeti komunikimi të qëndrueshëm;

b) Mundësinë e konsumatorit të paraqesë një ankesë *online* në faqen *web*, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me postë, sipas rastit;

c) Mundësinë e shkëmbimit të informacionit midis palëve, përmes mjeteve elektronike të komunikimit ose me postë, sipas rastit;

ç) Respektimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

2. Struktura e ZAM-it, sipas përcaktimit të nenit 52/2, të këtij ligji, siguron organizimin e brendshëm administrativ në mënyrë të tillë që garanton se në trajtimin e mosmarrëveshjeve në fushën e tyre të kompetencës, personat përgjegjës për këtë funksion:

a) Kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjes të konsumatorit në fushën përkatëse të kompetencës, si edhe njohuri të përgjithshme të së drejtës, të cilat mund të dëshmohen nga fusha e studimit, nga eksperienca e punës apo prova të tjera faktike;

b) Caktohen në ushtrimin e këtij funksioni për një afat kohor prej të paktën 4 vjetësh dhe të mos shkarkohen nga ky funksion pa pasur shkaqe të arsyeshme sipas legjislacionit përkatës në fuqi;

c) Nuk marrin apo përdorin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre asnjë udhëzim nga ndonjëra nga palët ose nga përfaqësuesit e tyre dhe në rastet kur një gjë e tillë vërtetohet nga njëra prej palëve, të sigurohet zëvendësimi i personit përgjegjës;

ç) Të shpërblehen në mënyrë që nuk ndikohet nga rezultatet e procedurës së trajtimit të mosmarrëveshjeve;

d) T'i bëjnë të njohur strukturës së ZAM-it çdo rrethanë, e cila mund të ndikojë ose mund të shihet se ndikon në pavarësinë dhe paanësinë e tyre, ose që mund të shkaktojë një konflikt interesi me ndonjërën nga palët në mosmarrëveshjen që u është kërkuar të zgjidhin pa vonesa të panevojshme. Detyrimi për të bërë të njohura rrethana të tilla është një detyrim i vazhdueshëm gjatë gjithë procedurës së ZAM-it, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Struktura ZAM, sipas përcaktimit të nenit 52/2, të këtij ligji, bën publike në faqen e saj të internetit, sipas kërkesës përmes një mjeti komunikimi të qëndrueshëm dhe në çdo mënyrë tjetër që e konsideron të përshtatshme, informacion të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm për:

a) Adresën dhe mënyrën e kontaktimit për procesin e ankimit apo trajtimit të mëtejshëm të mosmarrëveshjes, sipas këtij vendimi, duke përfshirë adresën postare dhe adresën e postës elektronike të tij;

b) Personin përgjegjës për trajtimin e ZAM-it, procedurën e caktimit dhe kohëzgjatjen e mandatit të tij;

c) Llojet e mosmarrëveshjeve brenda fushës së kompetencës së tyre;

ç) Rregullat procedurale që drejtojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje dhe shkaqet për të cilat një strukturë e ZAM-it mund të refuzojë të merret me një mosmarrëveshje të caktuar, në përputhje me përcaktimin e nenit 52/4 të këtij ligji;

d) Çdo kërkesë paraprake që palët duhet të përmbushin përpara se të nisë procedura e ZAM-it, përfshirë kërkesën për përpjekjen e konsumatorit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes drejtpërdrejt me tregtarin;

dh) Mundësinë e palëve për t'u tërhequr nga procedura;

e) Shpenzimet që duhen përballuar nga palët, si dhe procedurën e pagesës së tyre, nëse ka të tilla;

ë) Kohëzgjatjen mesatare të procedurës së ZAM-it;

f) Pasojat ligjore të rezultatit të procedurës së ZAM-it, duke përfshirë sanksionet për moszbatimin në rastin e një vendimi që ka efekt detyrues ndaj palëve, sipas rastit;

g) Procedurat për zbatimin e vendimit të ZAM-it, sipas rastit.

4. Ushtrojnë funksionin e një strukture ZAM, sipas parashikimeve të këtij ligji, vetëm ato struktura të cilat janë listuar si të tilla nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, sipas përcaktimit në pikën 9, të nenit 52, të këtij ligji.

Neni 52/4

Refuzimi i trajtimit të mosmarrëveshjeve nga struktura ZAM

1. Struktura ZAM, sipas përcaktimit të nenit 52/2, të këtij ligji, mund të refuzojë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje midis konsumatorit dhe tregtarit në fushën e kompetencës së tij, në rastet kur:

a) Konsumatori nuk është përpjekur të kontaktojë drejtpërdrejt dhe të kërkojë nga tregtari zgjidhjen e mosmarrëveshjes me anë të një zgjidhjeje miqësore;

b) Mosmarrëveshja është e parëndësishme ose abuzuese;

c) Mosmarrëveshja është duke u shqyrtuar ose është shqyrtuar më parë nga një strukturë tjetër e ZAM-it, nga një ndërmjetës i licencuar ose nga gjykata;

ç) Konsumatori nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë në strukturën ZAM brenda 1 viti kalendarik, nga data në të cilin konsumatori ka paraqitur ankesën e tij te tregtari;

d) Trajtimi i mosmarrëveshjes do të dëmtonte seriozisht funksionimin efikas të strukturës së ZAM-it.

2. Kur struktura ZAM, sipas përcaktimit të nenit 52/2, të këtij ligji, nuk është në gjendje të shqyrtojë një mosmarrëveshje që është kërkuar, i jep të dyja palëve një shpjegim të arsyetuar të shkaqeve për mosshqyrtimin e mosmarrëveshjes, brenda 21 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

3. Struktura ZAM, në rastin e rrethanave të përmendura në shkronjën "ç", të pikës 2, të nenit 52/3, siguron që:

a) Personi përgjegjës të zëvendësohet nga një person tjetër, të cilit i ngarkohet kryerja e procedurës së ZAM-it;

b) Në rast se zëvendësimi i parashikuar në shkronjën "a", të kësaj pike, nuk mund të realizohet, personi përgjegjës nuk kryen procedurën e ZAM-it, dhe strukturës së ZAM-it i duhet t'u propozojë palëve të paraqesin mosmarrëveshjen te një strukturë tjetër e ZAM-it, që është komptente për trajtimin e asaj mosmarrëveshjeje ose nga një gjykatë;

c) Në rast se procedurat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, nuk mund të realizohen, struktura ZAM, informon palët mbi rrethanat dhe vetëm nëse palët nuk kanë kundërshtuar pasi janë informuar për rrethanat dhe për të drejtën e tyre për të kundërshtuar, personi përgjegjës vijon kryerjen e procedurës së ZAM-it.

Neni 52/5

Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë trajtimit të mosmarrëveshjeve nga struktura ZAM

1. Gjatë procesit të shqyrtimit të mosmarrëveshjes ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit nga struktura ZAM, sipas përcaktimit të nenit 52/2, të këtij ligji, palët gëzojnë këto të drejta dhe detyrime:

a) Procedura e ZAM-it është e disponueshme dhe gjendet me lehtësi në rrugë elektronike dhe kopje të shtypura për të dyja palët, pavarësisht se ku gjenden;

b) Palët mund të paraqiten në proces pa qenë të detyruara të përfaqësohen nga një avokat ose një këshilltar ligjor, por procedura nuk mund t'i privojë palët nga e drejta e tyre për të marrë këshilla të pavarura ose për t'u përfaqësuar ose ndihmuar nga një palë e tretë në çdo fazë të procesit;

c) Procedura e ZAM-it është pa pagesë për konsumatorin;

ç) Struktura ZAM që ka marrë një ankesë njofton palët në mosmarrëveshje sapo të ketë marrë të gjitha dokumentet që përmbajnë informacionin përkatës që lidhet me ankesën;

d) Rezultati i procedurës së ZAM-it i njoftohet palëve brenda një periudhe prej 90 ditësh kalendarike, nga data në të cilën struktura ZAM ka marrë të gjithë dosjen e ankesës. Kur e gjykon të nevojshme, struktura ZAM mund ta zgjasë afatin prej 90 ditësh kalendarike. Palët duhet të informohen për çdo zgjatje të asaj periudhe dhe për kohëzgjatjen që mendohet se do të nevojitet për përfundimin e mosmarrëveshjes, por ky afat nuk mund të kalojë 60 ditë kalendarike, përtej afatit 90-ditor;

dh) Palët shprehin mendimin e tyre, si dhe marrin nga struktura ZAM argumentet, dëshmitë, dokumentet dhe faktet e paraqitura nga pala tjetër, çdo deklaratë dhe opinion që mund të jetë dhënë nga ekspertët, brenda një periudhe prej 15 ditësh kalendarike pas marrjes së njoftimit, sipas shkronjës "ç" të kësaj pike;

e) Palët njoftohen për rezultatin e procesit të ZAM-it me shkrim ose me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi dhe atyre u jepet një vendim i arsyetuar me shkaqet në të cilat është bazuar rezultati.

2. Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjes është detyruese për palët vetëm nëse ato janë informuar për natyrën detyruese të saj paraprakisht dhe nëse e kanë pranuar këtë shprehimisht.

3. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikën 2, të këtij neni, marrëveshja ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit për të paraqitur ankesa përpara strukturës ZAM nuk është detyruese për konsumatorin, nëse është bërë përpara se mosmarrëveshja të jetë

materializuar dhe nëse ka si pasojë privimin e konsumatorit nga e drejta për të bërë një padi në gjykatë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në rast se marrëveshja për ZAM-in është pjesë përbërëse e kontratës standarde të lidhur me konsumatorin, atëherë konsiderohet si një kusht i padrejtë kontraktor, sipas neneve 27 dhe 28 të këtij ligji.

4. Tregtari informon konsumatorët për strukturën ZAM, përgjegjëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, sipas fushës së veprimtarisë që ai kryen, në një mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe lehtësisht të përdorshme, në faqen e tij të internetit, nëse ka një faqe të tillë dhe në kushtet e përgjithshme të kontratës përkatëse, sipas rastit.

5. Tregtari, në rastin kur një mosmarrëveshje ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit, pas një ankese të bërë drejtpërdrejt te tregtari, nuk është zgjidhur, i jep konsumatorit informacionin, sipas përcaktimit të pikës 4, të këtij neni, në mënyrë të shkruar ose nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi.

Neni 52/6

Struktura përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik

1. Rregullat e parashikuara në nenet 52/3 deri në 52/5, të këtij ligji, zbatohen edhe gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik.

2. Detyrimi për zbatimin e këtyre dispozitave, sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet nga struktura përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik, që krijohet në varësi të ministrit.

3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të strukturës përgjegjëse, që përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.".

Neni 21

Në nenin 54, pika 1, shkronja "b", pas fjalëve "këshillimin e konsumatorëve" shtohen fjalët "sipas rastit, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore".

Neni 22

Në nenin 56 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën "a", pas fjalëve "për mbrojtjen e konsumatorëve" shtohen fjalët "strukturat e posaçme në njësitë e vetëqeverisjes vendore".

b) Shkronja "c" shfuqizohet.

c) Në shkronjën "ç" shtohen fjalët "ose ndërmjetësi i licencuar".

ç) Shkronja "dh" ndryshohet si më poshtë:

"dh) Çdo strukturë ZAM përgjegjëse, e krijuar posaçërisht për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji në nenet 52/2 deri në 52/6.".

2. Në pikën 2, pas fjalës "kritereve" shtohet fjala "shtesë".

Neni 23

Pas nenit 56 shtohet neni 56/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 56/1

Mbrojtja e konsumatorëve në nivel vendor

1. Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, në zbatim të përcaktimeve të shkronjave "e", "g" dhe "i", të pikës 2, të nenit 49, të këtij ligji, bashkëpunon dhe autorizon njësitë e vetëqeverisjes vendore për kryerjen e funksioneve për informimin, njoftimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve, si dhe për mbledhjen, seleksionimin e ankesave të konsumatorëve e, sipas rastit, përcjelljen e ankesave pranë strukturës përgjegjëse në nivel qendror.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për zbatimin e pikës 1, të këtij neni, mbështetur në përcaktimin e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", krijojnë struktura të posaçme.".

Neni 24

Në nenin 57 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në shkronjën "a" hiqen fjalët "pikat 3 dhe 4".

b) Në shkronjën "b", pas referencës së nenit 31 shtohen "32 dhe 33", si dhe hiqen fjalët "1% të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se".

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën "a", pas referencës së nenit 24, hiqen referencat në nenet "32, pika 3, dhe 33"; pas referencës së nenit 35, shtohen "36, 36/2 dhe 36/5"; pas referencës së nenit 43 shtohen "52/5, pika 4 dhe 5", si dhe hiqen fjalët "në masën 1% të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se".

b) Në shkronjën "b", pas referencës së nenit 29, hiqet referenca në nenin 33/1, shtohen referencat në nenet "37/5, 37/10, 37/11 dhe 37/13", sipas radhës, si dhe hiqen fjalët "në masën 2% të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se".

3. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 25
Dispozitë kalimtare

1. Deri në krijimin e strukturës përgjegjëse të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve të tjera, nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik, sipas parashikimit të nenit 52/6, të këtij ligji, përgjegjësitë dhe funksionet kryhen nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve.

2. Strukturat ZAM, të parashikuara në nenin 52/2, pika 1, të këtij ligji, fillojnë të ushtrojnë funksionet e parashikuara në këtë ligj, 6 muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 26
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të nenit 52/6, pika 3, dhe nenit 56, pika 2, të ligjit, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që bien në kundërshtim me të shfuqizohen.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.10.2018

Shpallur me dekretin nr. 10939, datë 9.11.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

SHTOJCA I
INFORMACION NË LIDHJE ME USHTRIMIN E SË DREJTËS SË HEQJES DORË NGA KONTRATA

A. Model udhëzimesh për heqjen dorë nga kontrata

E drejta e heqjes dorë nga kontrata

Ju keni të drejtën e heqjes dorë nga kjo kontratë brenda 14 ditëve, pa dhënë asnjë arsye.

Afati i heqjes dorë nga kontrata mbaron pas 14 ditëve nga dita.[2]

Për të ushtruar të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, duhet të na informoni në [3] për vendimin e heqjes dorë nga kjo kontratë, me anë të një deklarate të qartë (p.sh., një letër dërguar me postë, faks ose postë elektronike). Ju mund të përdorni modelin bashkëngjitur formularit të heqjes dorë nga kontrata, por ky nuk është i detyrueshëm.[4]

Me qëllim respektimin e afatit të heqjes dorë nga kontrata, mjafton që të dërgoni njoftimin tuaj në lidhje me ushtrimin e së drejtës së heqjes dorë nga kontrata përpara se të jetë plotësuar afati i heqjes dorë.

Efektet e heqjes dorë nga kontrata

[2] Udhëzime për plotësimin:
Vendosni një prej teksteve të mëposhtme në thonjëza:
a) "E lidhjes së kontratës", në rastin e një kontrate shërbimi ose të një kontrate për furnizim me ujë, gaz ose energji elektrike, kur ato nuk janë vendosur në shitje në një vëllim të kufizuar apo sasi të përcaktuar; ngrohje lokale; ose përmbajtje dixhitale, që nuk jepet në një mjet të trupëzuar.
b) "Ku ju ose një palë e tretë e ndryshme nga transportuesi dhe e autorizuar nga ju, merr në dorëzim mallrat", në rastin e një kontrate shitjeje.
c) "Për të cilat ju apo një pale e tretë e ndryshme nga transportuesi dhe e autorizuar nga ju, merr në dorëzim mallin të fundit.", në rastin e një kontrate që lidhet me disa lloje mallrash të porositura nga konsumatori në një porosi dhe të dorëzuara veç e veç.
ç) "Kur ju ose një palë e tretë, e ndryshme nga transportuesi dhe e autorizuar nga ju, merr në dorëzim lotin apo pjesën e fundit", në rastin e një kontrate që ka të bëjë me dorëzimin e një malli që përbëhet nga disa lote apo pjesë.
d) "Kur ju ose një palë e tretë, e ndryshme nga transportuesi dhe e autorizuar nga ju, merr në dorëzim mallin e parë", në rastin e një kontrate për furnizimin periodik të mallrave.
[3] Vendosni emrin tuaj, adresën postare dhe, nëse keni, numrin tuaj të telefonit, faksit dhe adresën e postës elektronike.
[4] Nëse i jepni konsumatorit mundësinë e plotësimit elektronikisht dhe të dërgojë njoftimin për heqjen dorë e tij nga kontrata, në *website*-in tuaj, vendosni paragrafin që vijon: "Ju mund ta plotësoni dhe ta dërgoni edhe elektronikisht formularin model të heqjes dorë nga kontrata ose çdo deklaratë tjetër të qartë në *website*-in tonë [vendosni adresën e internetit]. Nëse ju përdorni këtë opsion, ne do t'ju komunikojmë pa vonesë, konfirmimin e marrjes së njoftimit të heqjes dorë nga kontrata, me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi (p.sh., me postë elektronike)".

Nëse ju hiqni dorë nga kjo kontratë, ne do t'ju rimbursojmë të gjitha pagesat e marra prej jush, duke përfshirë shpenzimet e dorëzimit (me përjashtim të kostove shtesë që rezultojnë nga zgjedhja juaj, e një dërgese të ndryshme nga dërgesa standard më pak e kushtueshme, e ofruar prej nesh), pa vonesa të panevojshme, por gjithsesi jo më vonë se 14 ditë nga dita në të cilën ne njoftohemi për vendimin tuaj të heqjes dorë nga kjo kontratë. Ne do ta realizojmë një rimbursim të tillë, duke përdorur të njëjtat mjete pagese si ato të përdorura nga ju për transaksionin fillestar, përveçse kur ju keni rënë shprehimisht dakord ndryshe; gjithsesi, juve nuk do t'ju lindë asnjë kosto tjetër si rrjedhojë e një rimbursimi të tillë.

[5]

[6]

[7]

[4] Në rastin e një kontrate shitjeje ku ju nuk keni ofruar t'i merrni mallrat në rast të heqjes dorë nga kontrata, vendosni shprehjen për sa vijon: "Ne mund të mos e bëjmë rimbursimin përpara se të kemi marrë mallrat mbrapsht, ose përpara se ju të keni paraqitur provat se i keni kthyer mallrat, cilado qoftë më e para.".

[5] Në rast se konsumatori i ka marrë mallrat e lidhura me kontratën:

a) Vendosni:

- "Ne do t'i tërheqim vetë mallrat"; ose
- "Ju duhet t'i ktheni mallrat ose të na i dorëzoni ose... [vendosni emrin dhe adresën postare, sipas rastit, të personit të autorizuar prej jush për t'i marrë mallrat], pa vonesa të panevojshme, por gjithsesi, jo më vonë se 14 ditë nga dita, në të cilët do të na njoftoni për heqjen dorë tuajën nga kjo kontratë. Afati konsiderohet i respektuar prej jush, nëse ju na i ktheni mallrat përpara plotësimit të periudhës prej 14 ditësh".

b) Vendosni:

- "Ne do të mbulojmë shpenzimet e kthimit të mallrave";
- "Ju do të mbuloni shpenzimet e drejtpërdrejta të kthimit të mallrave";
- Nëse në një kontratë në largësi, ju nuk ofroni të paguani shpenzimet e kthimit të mallrave dhe për shkak të natyrës së tyre, mallrat nuk mund të kthehen normalisht me postë: "Ju do të duhet të përballoni shpenzimet e kthimit të mallrave... LEK [vendosni shumën]"; ose, nëse kostoja e kthimit të mallrave, në mënyrë të arsyeshme, nuk mund të llogaritet paraprakisht: "Ju do t'ju duhet të përballoni shpenzimet e drejtpërdrejta të kthimi të mallrave. Kostoja vlerësohet maksimumi afërsisht ... EUR/LEK [vendosni shumën]"; ose
- Nëse, në një kontratë jashtë qendrave tregtare, mallrat, për nga natyra e tyre, normalisht nuk mund të kthehen me postë dhe i janë dorëzuar konsumatorit në shtëpi në kohën e lidhjes së kontratës: "Ne do t'i marrim mallrat me shpenzimet tona"; dhe

c) Vendosni "Ju jeni përgjegjës për vlerën e pakësuar të mallit, që rezulton nga një përdorim i ndryshëm, nga ai që nevojitet për të përcaktuar natyrën, karakteristikën dhe funksionimin e tij".

[6] Në rastin e një kontrate për ofrimin e shërbimeve ose për furnizimin me ujë, gaz, energji elektrike, kur ato nuk janë vendosur në treg në vëllim të kufizuar ose në sasi të caktuar, ose për ngrohje lokale, vendosni paragrafin që vijon: "Nëse keni kërkuar të filloni kryerjen e shërbimeve ose furnizimin e ujit/gazit/energjisë elektrike/ngrohjen lokale [fshijeni sipas rastit] gjatë periudhës së heqjes dorë, do të na paguani një shumë, e cila është në përpjesëtim me atë që ju është dhënë, deri në kohën kur na keni njoftuar për heqjen tuaj dorë nga kjo kontratë, përkundrejt përmbushjes të plotë të kontratës".

[*] Fshijeni sipas rastit.

B. Formulari model i heqjes dorë nga kontrata

(Plotësojeni dhe dërgojeni këtë formular vetëm nëse dëshironi të tërhiqeni nga kontrata.)

- Drejtuar [këtu emri i tregtarit, adresa postare dhe numri i tij i faksit dhe adresa e postës elektronike, sipas rastit, duhet të vendosen nga tregtari]:
- Unë/Ne (*)[*] me anë të këtij formulari njoftoj/më (*), që unë/ne (*) tërhiqem/i (*) nga kontrata ime/jonë (*) e shitjes së mallrave të mëposhtme/për ofrimin e shërbimit të mëposhtëm (*);
- Porositur në (*)/marrë në (*);
- Emri i konsumatorit/i konsumatorëve;
- Adresa e konsumatorit/e konsumatorëve;
- Firma e konsumatorit/konsumatorëve (vetëm nëse ky formular njoftohet me letër);
- Data.

LIGJ
Nr. 72/2018

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN 2005 TË KONVENTËS PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË LUNDRIMIT DETAR, ADERUAR ME LIGJIN NR. 8850/2001, DHE PROTOKOLLIN 2005 TË PROTOKOLLIT PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË PLATFORMAVE FIKSE NË SHELFIN KONTINENTAL, ADERUAR ME LIGJIN NR. 8850/2001

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të

Paligjshme Kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr. 8850/2001, dhe Protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin nr. 8850/2001, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.10.2018

Shpallur me dekretin nr. 10940, datë 9.11.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

PROTOKOLLI I 2005 I KONVENTËS
PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË LUNDRIMIT DETAR

HYRJE

Shtetet Palë të këtij Protokolli,

duke qenë palë të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, bërë në Romë më 10 mars 1988;

duke pranuar se aktet terroriste kërcënojnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare;

duke pasur parasysh për Rezolutën A.924 (22) të Asamblesë së Organizatës Ndërkombëtare Detare që kërkon rishikimin e masave ekzistuese ndërkombëtare ligjore dhe teknike dhe shqyrtimin e masave të reja, me qëllim parandalimin dhe ndalimin e terrorizmit kundër anijeve dhe përmirësimin e sigurisë në bord dhe në breg dhe, në këtë mënyrë për të ulur rrezikun për pasagjerët, ekuipazhet dhe personelin e portit në bordin e anijeve dhe në zonat e porteve dhe anijet dhe ngarkesat e tyre;

të ndërgjegjshëm për Deklaratën mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar, bashkëlidhur Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 49/60, të datës 9 dhjetor 1994, në të cilën, ndër të tjera, Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara solemnisht rikonfirmojnë dënimin e tyre të prerë për të gjitha veprimet, metodat dhe praktikat e terrorizmit si kriminale dhe të pajustifikueshme, kudo dhe nga kushdo që i ka kryer, përfshirë ato që rrezikojnë marrëdhëniet miqësore midis shteteve dhe popujve dhe që kërcënojnë integritetin territorial dhe sigurinë e shteteve;

duke vërejtur Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 51/210, të datës 17 dhjetor 1996, dhe Deklaratën për Plotësimin e Deklaratës së vitit 1994 mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar , bashkëlidhur këtij Protokolli;

duke rikujtuar rezolutat 1368 (2001) dhe 1373 (2001) të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, të cilat pasqyrojnë vullnetin ndërkombëtar për të luftuar terrorizmin në të gjitha format dhe manifestimet e tij dhe që u ka caktuar detyra dhe përgjegjësi shteteve dhe, duke marrë parasysh kërcënimin e vazhdueshëm nga sulmet terroriste;

duke rikujtuar, gjithashtu, Rezolutën 1540 (2004) të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, e cila njeh nevojën urgjente për të gjitha shtetet që të marrin masa shtesë efektive për të parandaluar përhapjen e armëve bërthamore, kimike ose biologjike dhe mjetet e shpërndarjes së tyre;

duke rikujtuar më tej Konventën mbi Veprat Penale dhe disa Akte të tjera të Kryera në bordin avionit, bërë në Tokio më 14 shtator 1963; Konventën për Ndalimin e Konfiskimit të Paligjshëm të Avionëve, bërë në Hagë më 16 dhjetor 1970; Konventën për Ndalimin e Akteve të Paligjshme ndaj Sigurisë së Aviacionit Civil, bërë në Montreal më 23 shtator 1971; Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimeve kundër Personave të Mbrojtur Ndërkombëtarisht, përfshirë Agjentët Diplomatikë, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 14 dhjetor 1973; Konventën Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 17 dhjetor 1979; Konventën mbi Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore, bërë në Vjenë më 26 tetor 1979 dhe ndryshimet e tyre të miratuara më 8 korrik 2005; Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroportet që i shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar, plotësuese të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, bërë në Montreal më 24 shkurt 1988; Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në shelfin kontinental, bërë në Romë më 10 mars 1988; Konventën mbi Shënjimin e

Eksplozivëve Plastikë për Qëllimin e Zbulimit, bërë në Montreal më 1 mars 1991; Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Bombardimeve Terroriste, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 15 dhjetor 1997; Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Financimit të Terrorizmit, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 9 dhjetor 1999 dhe Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Akteve të Terrorizmit Bërthamor të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 13 prill të vitit 2005;

duke pasur parasysh rëndësinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit, bërë në Gjirin Montego më 10 dhjetor 1982, dhe të drejtën zakonore ndërkombëtare të detit;

duke pasur parasysh Rezolutën 59/46 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila rikonfirmoi se bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe veprimet e shteteve për të luftuar terrorizmin duhet të kryhen në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, së drejtës ndërkombëtare dhe konventave përkatëse ndërkombëtare dhe Rezolutën 59/24 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila u kërkoi shteteve të bëheshin palë në Konventën për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar dhe Protokollit të saj, ftoi shtetet të marrin pjesë në shqyrtimin e këtyre instrumenteve nga Komiteti Ligjor i Organizatës Detare Ndërkombëtare për të forcuar mjetet e luftimit, të tilla si aktet e paligjshme, duke përfshirë aktet terroriste, si dhe u kërkoi shteteve të marrin masat e duhura për të garantuar zbatimin efektiv të këtyre instrumenteve, veçanërisht nëpërmjet miratimit të legjislacionit, sipas rastit, me synim garantimin e një kuadri të duhur për reagimet ndaj incidenteve të grabitjes së armatosur dhe akteve terroriste në det;

duke marrë parasysh, gjithashtu, rëndësinë e ndryshimeve në Konventën Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974, dhe të Kodit Ndërkombëtar të Sigurisë së Anijeve dhe Objekteve të Porteve (ISPS), të miratuara nga Konferenca e Qeverive Kontraktuese e vitit 2002 për atë Konventë, një kuadër teknik të përshtatshëm ndërkombëtar që përfshin bashkëpunimin midis qeverive, agjencive qeveritare, administratave kombëtare dhe lokale dhe industrive të transportit detar dhe portual për të zbuluar kërcënimet ndaj sigurisë dhe për të marrë masa parandaluese kundër incidenteve të sigurisë që prekin anijet ose objektet e porteve të përdorura në tregtinë ndërkombëtare;

duke marrë më tej parasysh Rezolutën 58/187 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila riafirmoi se shtetet duhet të sigurojnë që çdo masë e marrë për të luftuar terrorizmin është në përputhje me detyrimet e tyre sipas së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht të drejtat ndërkombëtare të njeriut, ligjin për refugjatët dhe ligjin humanitar;

duke besuar se është e nevojshme të miratohen dispozita që plotësojnë dispozitat e Konventës për të ndaluar aktet e tjera terroriste të dhunës kundër sigurimit dhe sigurisë së lundrimit detar ndërkombëtar dhe për të përmirësuar efektivitetin e saj,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e këtij Protokolli:

1. "Konventë" nënkupton Konventën për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, bërë në Romë më 10 mars 1988.

2. "Organizatë" nënkupton Organizatën Ndërkombëtare Detare (IMO).

3. "Sekretar i Përgjithshëm" nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës.

Neni 2

Neni 1 i Konventës ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

Neni 1

1. Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) "Anije" nënkupton një mjet lundrues të çfarëdo lloji që nuk është i lidhur në mënyrë të përhershme me shtratin e detit, duke përfshirë anije të mbështetur në mënyrë dinamike, nëndetëse ose ndonjë anije tjetër lundruese.

b) "Transport" nënkupton fillimin, rregullimin ose ushtrimin e kontrollit efektiv, duke përfshirë autoritetin vendimmarrës, për lëvizjen e një personi ose sendi/objekti.

c) "Lëndim ose dëmtim serioz" nënkupton:

i. lëndimin e rëndë trupor; ose

ii. shkatërrim të gjerë të një vendi të përdorimit publik, strukturë shtetërore ose qeveritare, objekti

infrastrukturor ose sistemi të transportit publik, i cili rezulton në humbje të madhe ekonomike; ose

iii. dëm të konsiderueshëm në mjedis, përfshirë ajrin, tokën, ujin, faunën ose florën.

d) "Armë BCN" nënkupton:

i. "armë biologjike", të cilat janë:

1. Agjentë mikrobikë ose agjentë të tjerë biologjikë ose toksina, pavarësisht nga origjina ose metoda e prodhimit, të llojeve dhe sasive që nuk kanë justifikim për qëllime profilaktike, mbrojtëse ose qëllime të tjera paqësore; ose

2. Armë, pajisje ose mjete të shpërndarjes të projektuara për të përdorur agjentë ose toksina të tilla për qëllime armiqësore ose në konflikt të armatosur.

ii. "armë kimike", të cilat janë, së bashku ose veçmas:

1. Kimikate toksike dhe prekursorët e tyre, me përjashtim të rasteve, për:

A. Qëllime industriale, bujqësore, kërkimore, mjekësore, farmaceutike ose qëllime të tjera paqësore; ose

B. Qëllime mbrojtëse, specifikisht ato qëllime që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen nga kimikatet toksike dhe mbrojtjen nga armët kimike; ose

C. Qëllime ushtarake që nuk lidhen me përdorimin e armëve kimike dhe nuk varen nga përdorimi i vetive toksike të kimikateve si një metodë luftimi; ose

D. Zbatimi i ligjit, duke përfshirë qëllimet e kontrollit të brendshëm të trazirave,

për sa kohë që llojet dhe sasitë janë në përputhje me këto qëllime;

2. Municione dhe pajisje të projektuara posaçërisht për të shkaktuar vdekjen ose dëmtim tjetër nëpërmjet vetive toksike të atyre kimikateve toksike të specifikuara në nënparagrafin (ii) (1), të cilat do të çlirohen si rezultat i përdorimit të municioneve dhe pajisjeve të tilla;

3. Çdo pajisje të projektuar posaçërisht për përdorim në mënyrë të drejtpërdrejtë në lidhje me përdorimin e municioneve dhe pajisjeve të specifikuara në nënparagrafin (ii) (2).

iii. armët bërthamore dhe pajisje të tjera eksplozive bërthamore.

e) "Lëndë kimike toksike" nënkupton çdo lëndë kimike që përmes veprimit të saj kimik në proceset jetësore mund të shkaktojë vdekje, paaftësi të përkohshme ose dëmtim të përhershëm për njerëzit ose kafshët. Kjo përfshin të gjitha kimikatet e tilla, pavarësisht nga origjina ose metoda e tyre e prodhimit dhe pavarësisht nëse ato prodhohen në objekte, municione ose në vendndodhje të tjera.

f) "Prekursor" nënkupton çdo reagues kimik që merr pjesë në ndonjë fazë të prodhimit me çfarëdo metode të një lënde kimike toksike. Ky përfshin çdo komponent kyç të një sistemi kimik binar ose me shumë komponentë.

g) "Organizatë" nënkupton Organizatën Ndërkombëtare Detare (IMO).

h) "Sekretar i Përgjithshëm" nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) Termat "vend i përdorimit publik", "objekt shtetëror ose qeveritar", "objekt infrastrukturor" dhe "sistem i transportit publik" kanë të njëjtin kuptim si ato të dhëna në Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Bombardimeve Terroriste, bërë në Nju-Jork më 15 dhjetor 1997; dhe

b) Termat "material burimor" dhe "material special i zbërthyeshëm" kanë të njëjtin kuptim si ato të dhëna në Statutin e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA), bërë në Nju-Jork më 26 tetor 1956.

Neni 3

Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 2bis i Konventës:

"Neni 2bis

1. Asgjë në këtë Konventë nuk do të ndikojë në të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shteteve dhe individëve, sipas së drejtës ndërkombëtare, në veçanti qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të të drejtave ndërkombëtare të njeriut, ligjit për refugjatët dhe të drejtën humanitare.

2. Kjo Konventë nuk zbatohet për aktivitetet e forcave të armatosura gjatë një konflikti të armatosur, pasi këta terma kuptohen sipas së drejtës humanitare ndërkombëtare, të cilët rregullohen nga ai ligj dhe aktivitetet e ndërmarra nga forcat ushtarake të një shteti në ushtrimin e detyrat zyrtare, në masën që ato udhëhiqen nga rregulla të tjera të së drejtës ndërkombëtare.

3. Asgjë në këtë Konventë nuk do të ndikojë në të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë sipas Traktatit për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore, bërë në Uashington, Londër dhe Moskë më 1 korrik 1968,

Konventën për Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit dhe Magazinimit të Armëve Bakteriologjike (Biologjike) dhe Toksinave dhe Shkatërrimin e tyre, bërë në Uashington, Londër dhe Moskë më 10 prill 1972, ose Konventën për Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit, magazinimit dhe Përdorimit të Armëve Kimike dhe për Shkatërrimin e tyre, bërë në Paris më 13 janar 1993, të shteteve palë në këto traktate.".

Neni 4

1. Neni 3 i paragrafit 1 të Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim:

"Çdo person kryen një shkelje në kuptim të kësaj Konvente, nëse ai person në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme:".

2. Neni 3, paragrafi 1 (f) i Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim:

"f) Komunikon informacionin për të cilin ai person është në dijeni se është i rremë, duke rrezikuar në këtë mënyrë lundrimin e sigurt të një anijeje.".

3. Neni 3, paragrafi 1 (g) i Konventës hiqet.

4. Neni 3, paragrafi 2 i Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim: "2. Çdo person kryen. Gjithashtu. një vepër penale, nëse ai person kërcënon, me ose pa kusht, siç parashikohet në të drejtën kombëtare, me synim detyrimin e një personi fizik ose juridik për të kryer ose mos kryer ndonjë veprim, për të kryer ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në paragrafët 1 (b), (c) dhe (e), nëse ky kërcënim mund të rrezikojë lundrimin e sigurt të anijes në fjalë.".

5. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 3bis i Konventës:

"Neni 3bis

1. Çdo person kryen një vepër penale në kuptim të kësaj Konvente, nëse ai person në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme:

a) Kur qëllimi i veprimit, sipas natyrës ose kontekstit të tij, është që të frikësojë një popullsi ose të detyrojë një qeveri ose organizatë ndërkombëtare për të kryer, për të mos kryer ndonjë veprim:

i. përdor kundër ose në anije ose shkarkon nga një anije ndonjë material eksploziv, radioaktiv ose armë BCN, në një mënyrë që shkakton ose mund të shkaktojë vdekje ose lëndim ose dëmtimi serioz; ose

ii. shkarkon nga një anije naftë, gaz natyror të lëngshëm ose substancë tjetër të rrezikshme ose të dëmshme, e cila nuk mbulohet nga nënparagrafi (a) (i), në sasi ose përqendrim të tillë që shkakton ose mund të shkaktojë vdekje ose lëndim ose dëmtim serioz; ose

iii. përdor një anije në një mënyrë që shkakton vdekjen ose lëndimin ose dëmtimin serioz; ose

iv. kërcënon, me ose pa kushte, siç parashikohet në të drejtën kombëtare, për të kryer një vepër penale të përcaktuar në nënparagrafin (a) (i), (ii) ose (iii); ose

b) Transporton në bordin e një anijeje:

i. ndonjë material eksploziv ose radioaktiv, duke qenë në dijeni se është synuar të përdoret për të shkaktuar ose në një kërcënim për të shkaktuar me ose pa kushte, siç parashikohet në ligjin kombëtar, vdekjen ose lëndimin ose dëmtimin serioz, me qëllim për të frikësuar një popullsi ose për të detyruar një qeveri ose organizatë ndërkombëtare për të vepruar ose për të mos vepruar; ose

ii. çdo armë BCN, duke qenë në dijeni se është armë BCN, siç përcaktohet në nenin 1; ose

iii. çdo material burimor, material special të zbërthyeshëm ose pajisje, ose material të projektuar, ose të përgatitur posaçërisht për përpunimin, përdorimin ose prodhimin e materialit special të zbërthyeshëm, duke qenë në dijeni se është synuar të përdoret në një aktivitet bërthamor eksploziv ose në çdo aktivitet tjetër bërthamor jo nën masa mbrojtëse, në përputhje me një marrëveshje gjithëpërfshirëse të masave mbrojtëse të IAEA-s; ose

iv. çdo pajisje, materiale ose *software* ose teknologji të ngjashme që në mënyrë të konsiderueshme kontribuon në projektimin, prodhimin ose dorëzimin e një arme BCN, me qëllim që të përdoret për këtë qëllim.

2. Nuk do të jetë vepër penale, në kuptim të kësaj Konvente, transportimi i një sendi ose materiali të mbuluar nga paragrafi 1 (b) (iii) ose në masën që lidhet me një armë bërthamore ose pajisje të tjera eksplozive bërthamore, paragrafi 1 (b) (iv), nëse një artikull ose material i tillë transportohet në ose nga territori, ose është transportuar ndryshe nën kontrollin e një Shteti Palë të Traktatit për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore, ku:

a) Transferimi ose marrja rrjedhuese, duke përfshirë edhe atë të brendshëm të një shteti, të

artikullit ose materialit nuk është në kundërshtim me detyrimet e Palës së tillë të Shtetit, sipas Traktatit për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore; dhe

b) Nëse artikulli ose materiali synohet për sistemin e shpërndarjes së një arme bërthamore ose mjeteve të tjera eksplozive bërthamore të një Shteti Palë të Traktatit për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore, mbajtja e një arme ose pajisjeje të tillë nuk është në kundërshtim me detyrimet e Shtetit Palë sipas atij Traktati.".

6. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 3ter i Konventës:

"Neni 3ter

Çdo person kryen një vepër penale në kuptim të kësaj Konvente, nëse ai person në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme transporton një person tjetër në bordin e një anijeje, duke qenë në dijeni se personi ka kryer një veprim që përbën vepër penale të parashikuar në nenin 3, 3bis ose 3ter ose një vepër penale në çdo traktat të renditur në shtojcë dhe duke synuar që ta ndihmojë atë person për t'iu shmangur ndjekjes penale.".

7. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 3quater i Konventës:

"Neni 3quater

Çdo person kryen, gjithashtu, vepër penale, në kuptimin e kësaj Konvente, nëse ai person:

a) Lëndon ose vret në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme ndonjë person në lidhje me kryerjen e ndonjë prej veprave penale të përcaktuara në nenin 3, paragrafi 1, neni 3bis ose neni 3ter; ose

b) Kryen një vepër penale në tentativë, të përcaktuar në nenin 3, paragrafi 1, neni 3bis, paragrafi 1 (a) (i), (ii) ose (iii) ose nënparagrafi (a) i këtij neni; ose

c) Merr pjesë si bashkëpunëtor në një shkelje të parashikuar në nenin 3, nenin 3bis, nenin 3ter, ose nënparagrafët (a) ose (b) të këtij neni; ose

d) Organizon ose drejton të tjerët për të kryer një vepër penale të përcaktuar në nenin 3, nenin 3bis, nenin 3ter ose nënparagrafët (a) ose (b) të këtij neni; ose

e) Kontribuon në kryerjen e një ose më shumë veprave penale të parashikuara në nenin 3, nenin 3bis, nenin 3ter ose nënparagrafët (a) ose (b) të këtij neni, nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët, në mënyrë të qëllimshme; dhe, ose:

i. me qëllim të ndihmës për zhvillim të veprimtarisë kriminale ose qëllimit kriminal të grupit, kur një aktivitet ose qëllim i tillë përfshin kryerjen e një vepre penale të përcaktuar në nenin 3, 3bis ose 3ter; ose

ii. në njohurinë e qëllimit të grupit për të kryer një vepër penale të parashikuar në nenin 3, 3bis ose 3ter.".

Neni 5

1. Neni 5 i Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim:

"Çdo Shtet Palë do të kryejë veprat penale të përcaktuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, të dënueshme me dënime të përshtatshme, të cilat marrin parasysh natyrën e rëndë të këtyre veprave penale.".

2. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 5bis i Konventës:

"Neni 5bis

1. Çdo Shtet Palë, në përputhje me parimet e saj të brendshme ligjore, do të marrë masat e nevojshme për të mundësuar që një person juridik, i vendosur në territorin e tij ose i organizuar sipas ligjeve të tij, të jetë përgjegjës kur personi përgjegjës për menaxhimin ose kontrollin e atij personi juridik, në atë cilësi, ka kryer një vepër penale të përcaktuar në këtë Konventë. Një përgjegjësi e tillë mund të jetë penale, civile ose administrative.

2. Kjo përgjegjësi shkaktohet pa cenuar përgjegjësinë penale të individëve që kanë kryer veprat penale.

3. Çdo Shtet Palë duhet të sigurojë, në veçanti, që personat juridikë përgjegjës, në përputhje me paragrafin 1 të jenë subjekt i sanksioneve penale, civile ose administrative efektive, proporcionale dhe bindëse. Sanksionet e tilla mund të përfshijnë sanksione monetare.".

Neni 6

1. Kapitulli i nenit 6, paragrafi 1 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

"1. Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, kur vepra është kryer:".

2. Neni 6, paragrafi 3 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

"3. Çdo Shtet Palë që ka vendosur juridiksionin e përmendur në paragrafin 2 duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm. Nëse një Shtet Palë i tillë më pas e shfuqizon atë juridiksion, ajo do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm.".

3. Neni 6, paragrafi 4 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

"4. Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, në rastet kur autori i dyshuar ndodhet në territorin e tij dhe nuk ekstradon shkelësin e dyshuar në cilindo nga Shtetet Palë që kanë vendosur juridiksionin e tyre në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.".

Neni 7

Teksti i mëposhtëm është shtuar si Shtojca e Konventës:

"SHTOJCË

1. Konventa për Ndalimin e Konfiskimit të Paligjshëm të Avionëve, bërë në Hagë më 16 dhjetor 1970.

2. Konventa për Ndalimin e Akteve të Paligjshme ndaj Sigurisë së Aviacionit Civil, bërë në Montreal më 23 shtator 1971.

3. Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimeve kundër Personave të Mbrojtur Ndërkombëtarisht, përfshirë agjentët diplomatikë, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 14 dhjetor 1973.

4. Konventa Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 17 dhjetor 1979.

5. Konventa për Mbrojtjen Fizike të Materialit Bërthamor, bërë në Vjenë më 26 tetor 1979.

6. Protokolli për Ndalimin e Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroporte që i Shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar, në plotësim të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme ndaj Sigurisë së Aviacionit Civil, bërë në Montreal më 24 shkurt 1988.

7. Protokolli për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental, bërë në Romë më 10 mars 1988.

8. Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Bombardimeve Terroriste, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 15 dhjetor 1997.

9. Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Financimit të Terrorizmit, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 9 dhjetor 1999.".

Neni 8

1. Neni 8, paragrafi 1 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

"1. Zotëruesi i një anijeje të një Shteti Palë (Shteti i flamurit) mund të dorëzojë tek autoritetet e çdo Shteti tjetër Palë (Shteti pritës) çdo person për të cilin kapiteni i anijes ka arsye bindëse për të besuar se ka kryer një vepër penale të përcaktuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater.".

2. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 8bis i Konventës:

"Neni 8bis

1. Shtetet Palë do të bashkëpunojnë, në masën më të plotë të mundshme, për të parandaluar dhe për të ndaluar aktet e paligjshme të mbuluara nga kjo Konventë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe do t'u përgjigjen kërkesave sipas këtij neni sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Çdo kërkesë sipas këtij neni, nëse është e mundur, duhet të përmbajë emrin e anijes së dyshuar, numrin identifikues të anijes së IMO-s, portin e regjistrimit, portet e origjinës dhe destinacionit dhe çdo informacion tjetër përkatës. Nëse kërkesa përcillet verbalisht, Pala kërkuese do ta konfirmojë kërkesën me shkrim sa më parë që të jetë e mundur. Pala e kërkuar do të konfirmojë menjëherë pranimin e saj të çdo kërkese me shkrim ose verbalisht.

3. Shtetet Palë do të marrin në konsideratë rreziqet dhe vështirësitë e përfshira në hipjen në anije në det dhe në kërkim të ngarkesës së saj, dhe do të shqyrtojë nëse masat e tjera të përshtatshme të rëna dakord midis shteteve të interesuara mund të merren në mënyrë më të sigurt në portin e ardhshëm të thirrjes ose në vendndodhje të tjera.

4. Një Shtet Palë që ka arsye bindëse për të dyshuar se një vepër penale e parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater është kryer, po kryhet ose do të kryhet, duke përfshirë një anije që valëvit flamurin e saj, mund të kërkojë ndihmën e shteteve të tjera Palë në parandalimin ose ndalimin e kësaj vepre penale. Shtetet Palë që kanë kërkuar në këtë mënyrë, duhet të ushtrojnë përpjekjet e tyre më të mira për të dhënë një ndihmë të tillë brenda

mjeteve në dispozicion të tyre.

5. Kurdo që zyrtarët e zbatimit të ligjit ose zyrtarët e tjerë të autorizuar të një Shteti Palë (Pala kërkuese) ndeshen me një anije që valëvit flamurin ose shfaq shenjat e regjistrimit të një Shteti tjetër Palë (Pala e Parë) që ndodhet në drejtimin e detit territorial të ndonjë shteti dhe Pala kërkuese ka arsye bindëse për të dyshuar se anija ose personi në bordin e anijes ka qenë, është ose do të përfshihet në kryerjen e një vepre penale të parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater dhe Pala kërkuese dëshiron të hipë në anije,

a) Do të kërkojë, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, që Pala e Parë të konfirmojë pretendimin e shtetësisë; dhe

b) Nëse konfirmohet shtetësia, Pala kërkuese do t'i kërkojë Palës së parë (në vijim i referuar si "Shteti i flamurit") për autorizim të bordit dhe të marrë masat e duhura në lidhje me atë anije që mund të përfshijë ndalimin, hipjen dhe kërkimin anijeve, ngarkesave të tij dhe të personave në bord, dhe marrjen në pyetje të personave në bord për të përcaktuar nëse një vepër penale e parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater është duke u kryer apo do të kryhet; dhe

c) Shteti i flamurit ose do të:

i. autorizojë Palën kërkuese të hipë në anije dhe të ndërmarrë masat e duhura të përcaktuara në nënparagrafin (b), në bazë të kushteve që mund të vendosë në përputhje me paragrafin 7; ose

ii. realizojë hipjen në anije dhe kërkimin me zyrtarët e vet të zbatimit të ligjit ose zyrtarë të tjerë; ose

iii. realizojë hipjen në anije dhe kërkimin së bashku me Palën kërkuese, në bazë të kushteve që mund të vendosë në përputhje me paragrafin 7; ose

iv. refuzojë autorizimin e hipjes në anije dhe kërkimin.

Pala kërkuese nuk mund të hipë në anije ose nuk mund të marrë masat e përcaktuara në nënparagrafin (b) pa autorizimin e shprehur të shtetit të flamurit.

d) Në momentin e, ose pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një Shtet Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm, se, në lidhje me anijet që valëvisin flamurin e tij ose shfaqin shenjën e tij të regjistrimit, Palës kërkuese i jepet autorizim për të hipur dhe për të kontrolluar anijen, ngarkesën e saj dhe personat në bord dhe për të pyetur personat në bord për të gjetur dhe për të shqyrtuar dokumentacionin e kombësisë së saj, dhe për të përcaktuar nëse një vepër penale e parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater është kryer, është duke u kryer ose do të kryhet, nëse nuk ka përgjigje nga Pala e parë brenda katër orëve nga pranimi i marrjes së një kërkese për të konfirmuar shtetësinë.

e) Në momentin e, ose pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një Shtet Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm, se, në lidhje me Palës kërkuese i jepet autorizim për të hipur dhe për kontrolluar anijen, anijet që valëvisin flamurin e tij ose shfaqin shenjën e tij të regjistrimit dhe të kërkojë një anije, ngarkesën e tij dhe personat në bord, dhe për të pyetur personat në bord për të përcaktuar nëse një vepër penale e parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater ka qenë kryer, është duke u kryer ose do të kryhet.

Njoftimet e bëra sipas këtij paragrafi mund të tërhiqen në çdo kohë.

6. Kur dëshmia e kryerjes e përshkruar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater është gjetur si rezultat i çdo bordi të kryer sipas këtij neni, shteti flamur mund të autorizojë Palën kërkuese që të ndalojë anijen, ngarkesën dhe personat në bord, në pritje të marrjes së udhëzimeve të disponimit nga shteti i flamurit. Pala kërkuese menjëherë do të informojë shtetin e flamurit mbi rezultatet e bordit, kërkimin dhe ndalimin e kryer sipas këtij neni. Pala kërkuese, gjithashtu, do të informojë menjëherë shtetin flamur për zbulimin e provave të kryerjes së paligjshme që nuk i nënshtrohet kësaj Konvente.

7. Shteti i flamurit, në përputhje me dispozitat e tjera të kësaj Konvente, mund t'i nënshtrohet autorizimit të tij, sipas paragrafit 5 ose 6 të kushteve, duke përfshirë marrjen e informacionit shtesë nga Pala kërkuese dhe kushteve në lidhje me përgjegjësinë dhe shtrirjen e masave që duhet të ndërmerren. Asnjë masë shtesë nuk mund të merret pa autorizimin e shprehur të shtetit të flamurit, përveç kur është e nevojshme për të lehtësuar rrezikun e menjëhershëm për jetën e personave ose kur ato masa rrjedhin nga marrëveshjet përkatëse dypalëshe ose shumëpalëshe.

8. Për të gjitha bordet sipas këtij neni, shteti i flamurit ka të drejtë të ushtrojë juridiksion mbi një anije, ngarkesë ose sende të tjera të ndaluara, si dhe personave në bord, duke përfshirë konfiskimin, sekuestrimin, ndalimin dhe ndjekjen penale.

Megjithatë, sipas kushtetutës dhe ligjeve të tij, shteti i flamurit mund të miratojë ushtrimin e juridiksionit nga një shtet tjetër që ka juridiksion sipas nenit 6.

9. Gjatë kryerjes së veprimeve të autorizuara sipas këtij neni, përdorimi i forcës duhet të shmanget, përveç kur është e nevojshme për të garantuar sigurinë e zyrtarëve të tij dhe të personave në bord ose kur zyrtarët pengohen në kryerjen e veprimeve të autorizuara. Çdo përdorim i forcës sipas këtij neni nuk duhet të tejkalojë shkallën minimale të forcës që është e nevojshme dhe e arsyeshme sipas rrethanave.

10. Masat mbrojtëse:

a) Kur një Shtet Palë merr masa kundër një anijeje, në përputhje me këtë nen, ai duhet:

i. të marrë parasysh nevojën për të mos rrezikuar sigurinë e jetës në det;

ii. të sigurojë që të gjithë personat në bord të trajtohen në një mënyrë që ruan dinjitetin e tyre themelor njerëzor dhe në përputhje me dispozitat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;

iii. të sigurojë që një hipje në anije dhe kërkim sipas këtij neni, të kryhet në përputhje me ligjin ndërkombëtar në fuqi;

iv. të marrë parasysh sigurinë dhe sigurinë e anijes dhe ngarkesës së tij;

v. të marrë parasysh nevojën për të mos paragjykuar interesat komercialë ose ligjorë të shtetit flamur;

vi. të sigurojë, brenda mjeteve të disponueshme, që çdo masë e marrë në lidhje me anijen ose ngarkesën e saj është e përshtatshme për mjedisin;

vii. të sigurojë që personave në bord, kundër të cilëve mund të fillojnë procedimet në lidhje me ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater, t'u sigurohet mbrojtja sipas paragrafit 2 të nenit 10, pavarësisht vendndodhjes;

viii. të sigurojë që kapiteni i një anijeje të kështillohet për qëllimin e tij për të hipur dhe i jepet ose i është dhënë mundësia të kontaktojë pronarin e anijes dhe shtetin e flamurit, sa më shpejt që të jetë e mundur; dhe

ix. të ndërmarrë përpjekje të arsyeshme për të shmangur një anije të ndaluar ose të vonuar.

b) Me kusht që autorizimi për t'u bartur nga një shtet flamur nuk do të rezultojë në përgjegjësinë e tij, Shtetet Palë do të jenë përgjegjëse për çdo dëm, dëmtim apo humbje që u atribuohet atyre, të cilat rrjedhin nga masat e marra në zbatim të këtij neni, kur:

i. arsyet për masa të tilla nuk janë të bazuara, me kusht që anija të mos ketë kryer asnjë veprim që justifikon masat e marra; ose

ii. masa të tilla janë të paligjshme ose tejkalojnë ato që kërkohen në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh informacionin në dispozicion për të zbatuar dispozitat e këtij neni. Shtetet Palë do të sigurojnë një mbështetje të efektshme në lidhje me një dëm, dëmtim apo humbje të tillë.

c) Kur një Shtet Palë merr masa kundër një anijeje në përputhje me këtë Konventë, duhet të marrë në konsideratë nevojën për të mos ndërhyrë ose ndikuar:

i. në të drejtat dhe detyrimet dhe ushtrimi i juridiksionit të shteteve bregdetare, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të detit; ose

ii. në autoritetin e shtetit të flamurit për të ushtruar juridiksion dhe kontroll në çështjet administrative, teknike dhe sociale që përfshijnë anijen.

d) Çdo masë e marrë sipas këtij neni do të kryhet nga zyrtarët e zbatimit ligjit ose nga zyrtarë të tjerë të autorizuar nga anijet luftarake ose avionë ushtarakë ose nga anije ose avionë të tjerë të shënjuar qartë dhe të identifikueshëm si të shërbimit të qeverisë dhe të autorizuar për këtë qëllim dhe, nenet 2 dhe 2bis do të zbatohen sipas dispozitave të këtij neni.

e) Për qëllimet e këtij neni, "zyrtarë të zbatimit të ligjit ose zyrtarë të tjerë të autorizuar" nënkupton anëtarë të veshur me uniformë ose ndryshe qartësisht të identifikueshëm të organeve të zbatimit të ligjit ose të autoriteteve të tjera qeveritare të autorizuara, siç duhet nga qeveria e tyre. Për qëllimin specifik të zbatimit të ligjit sipas kësaj Konvente, zyrtarë të zbatimit të ligjit ose zyrtarë të tjerë të autorizuar duhet të ofrojnë dokumente të përshtatshme identifikimi të lëshuara nga qeveria për shqyrtim nga ana e kapitenit të anijes gjatë hipjes në anije.

11. Ky nen nuk zbatohet ose kufizohet me hipjen në anije, të kryera nga çdo shtet palë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, në drejtim të detit territorial të çdo shteti, duke përfshirë hipjet në anije të bazuara në të drejtën e vizitës, dhënien e ndihmës për personat, anijet dhe pronat në situatë problematike ose rrezik, ose një autorizim nga shteti i flamurit për të marrë masa për zbatimin e ligjit ose masa të tjera.

12. Shtetet Palë inkurajohen që të zhvillojnë procedura standarde funksionale për operacionet e përbashkëta në pajtim me këtë nen dhe të konsultohen, sipas rastit, me Palët e tjera Shtetërore, me qëllim harmonizimin e procedurave të tilla standarde funksionale për kryerjen e operacioneve.

13. Shtetet Palë mund të lidhin marrëveshje ose masa ndërmjet tyre për të lehtësuar veprimet e zbatimit të ligjit të kryera në përputhje me këtë nen.

14. Secili Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura për të siguruar që zyrtarët e tij të zbatimit të ligjit ose zyrtarë të tjerë të autorizuar dhe zyrtarë të tjerë të zbatimit të ligjit ose të autorizuar të shteteve të tjera palë që veprojnë në emër të tij, të jenë të autorizuar për të vepruar sipas këtij neni.

15. Në momentin e, ose pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, çdo Shtet Palë do të caktojë autoritetin ose, kur është e nevojshme, autoritetet për të marrë dhe për t'iu përgjigjur kërkesave për ndihmë, për konfirmimin e shtetësisë dhe autorizimin për të marrë masat e duhura. Një përcaktim i tillë, duke përfshirë informacionin e personit të kontaktit, duhet t'i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm brenda një muaji nga bërja Palë, i cili do të informojë të gjitha Shtetet e tjera Palë brenda një muaji nga përcaktimi. Secili Shtet Palë është përgjegjës për njoftimin e menjëhershëm nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm për çdo ndryshim në përcaktimin ose informacionin e personit të kontaktit.".

Neni 9

Neni 10, paragrafi 2, zëvendësohet me tekstin në vijim:

"2. Çdo person në paraburgim ose për të cilin merren masa të tjera ose për të cilin janë duke u zhvilluar procedime në pajtim me këtë Konventë, garantohet trajtimi i drejtë, duke përfshirë gëzimin e të gjitha të drejtave dhe garancive, në përputhje me ligjin e shtetit në territorin e të cilit ndodhet dhe dispozitat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.".

Neni 10

Neni 11, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, janë zëvendësuar me tekstin në vijim:

"1. Veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater do të konsiderohen të përfshihen si vepra të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që ekziston ndërmjet ndonjë prej Shteteve Palë. Shtetet Palë marrin përsipër të përfshijnë vepra të tilla si vepra të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që do të lidhet ndërmjet tyre.

2. Nëse një Shtet Palë që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një traktati, pranon një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë, me të cilin nuk ka traktate për ekstradim, Shteti Palë i kërkuar mund të zgjedhë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradim ,në lidhje me veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater. Ekstradimi u nënshtrohet kushteve të tjera të parashikuara nga ligji i shtetit palë të kërkuar.

3. Shtetet Palë që nuk e kushtëzojnë ekstradimin nga ekzistenca e një traktati, duhet të njohin veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, si vepra të ekstradueshme ndërmjet tyre, sipas kushteve të parashikuara nga ligji i shtetit palë të kërkuar.

4. Nëse është e nevojshme, veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater do të trajtohen, për qëllime të ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë, sikur të ishin kryer jo vetëm në vendin ku ndodheshin, por edhe në një vend brenda juridiksionit të Shtetit Palë që kërkon ekstradimin.".

2. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 11bis i Konventës:

"Neni 11bis

Asnjë nga shkeljet e parashikuara në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater nuk konsiderohet për qëllime të ekstradimit ose të ndihmës së ndërsjellë juridike si vepër politike ose si vepër penale e lidhur me një vepër politike ose si vepër e frymëzuar nga motive politike. Si rrjedhojë, kërkesa për ekstradim ose ndihmë të ndërsjellë juridike, bazuar në një shkelje të tillë nuk mund të refuzohet vetëm për shkak se lidhet me një vepër politike apo vepër penale të lidhur me një vepër politike ose vepër të frymëzuar nga motive politike.".

3. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 11ter i Konventës:

"Neni 11ter

Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si detyrim për të ekstraduar ose për të ofruar ndihmë të ndërsjellë juridike, nëse Shteti Palë i kërkuar ka arsye bindëse për të besuar se kërkesa për ekstradim për veprat penale të përcaktuara në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater ose për ndihmën e ndërsjellë juridike, në lidhje me këto vepra penale, është bërë me qëllim të ndjekjes penale ose të dënimit të një personi për shkak të racës, fesë, kombësisë, origjinës etnike, mendimit politik ose gjinisë së atij personi, ose që pajtueshmëria me kërkesën do të cenonte pozicionin e personit për ndonjë nga këto arsye.".

Neni 11

1. Neni 12, paragrafi 1 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

"1. Shtetet Palë i ofrojnë njëri-tjetrit masën më të madhe të ndihmës në lidhje me procedimet penale të filluara, për shkeljet e parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, duke përfshirë ndihmën në marrjen e provave në dispozicion të tyre, të nevojshme për procedimet.".

2. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 12bis i Konventës:

"Neni 12bis

1. Personi i cili ndodhet në paraburgim ose është duke kryer një dënim në territorin e një Shteti Pale, prania e të cilit në një Shtet tjetër Palë kërkohet për qëllime të identifikimit, dëshmisë ose ndryshe dhënies së ndihmës në marrjen e provave për hetimin ose ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater, mund të transferohet nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Personi jep lirisht pëlqimin e vetëdijshëm; dhe

b) Autoritetet kompetente të të dyja shteteve bien dakord, në bazë të kushteve të tilla që ato shtete mund të konsiderojnë të përshtatshme.

2. Për qëllimet e këtij neni:

a) Shteti në të cilin transferohet personi ka autoritetin dhe detyrimin për ta mbajtur personin e transferuar në paraburgim, përveç nëse kërkohet ose autorizohet ndryshe nga shteti nga i cili është transferuar personi;

b) Shteti në të cilin transferohet personi do të zbatojë pa vonesë detyrimin e tij për kthimin e personit në paraburgim të shtetit nga i cili personi transferohet, siç është rënë dakord paraprakisht ose siç është rënë dakord ndryshe nga autoritetet kompetente të të dyja shteteve;

c) Shteti në të cilin transferohet personi, nuk do të kërkojë nga shteti nga i cili është transferuar personi, fillimin e procedurave të ekstradimit për kthimin e personit;

d) Personi i transferuar do të marrë konfirmimin për kryerjen e dënimit që kryhet në shtetin nga i cili personi është transferuar për periudhën e kaluar në paraburgim të shtetit në të cilin është transferuar personi.

3. Përveç nëse shteti palë nga i cili një person duhet të transferohet në përputhje me këtë nen bie dakord për këtë, ai person, me çfarëdo lloj shtetësie, nuk do të ndiqet penalisht, nuk do të ndalohet ose nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale në territorin e shtetit në të cilin ky person transferohet, në lidhje me veprat ose dënimet e mëparshme përpara largimit të atij personi nga territori i shtetit nga i cili ky person është transferuar.".

Neni 12

Neni 13 i Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim:

"1. Shtetet Palë bashkëpunojnë për parandalimin e veprave penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, veçanërisht nga:

a) Marrja e të gjitha masave praktike për të parandaluar përgatitjen në territoret e tyre përkatëse për kryerjen e atyre veprave penale brenda ose jashtë territoreve të tyre;

b) Shkëmbimi i informacionit në përputhje me të drejtën e tyre kombëtare dhe bashkërendimin e masave administrative dhe masave të tjera të marra sipas rastit, për të parandaluar kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater.

2. Kur për shkak të kryerjes së një vepre penale të përcaktuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater, kalimi i një anijeje është vonuar ose ndërprerë, çdo Shtet Palë në territorin e së cilës ndodhet anija, udhëtarët ose ekuipazhi, duhet të jetë i detyruar të ushtrojë të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur një anije, pasagjerët, ekuipazhin ose ngarkesën e tij që mbahet në mënyrë të padrejtë ose të vonuar.".

Neni 13

Neni 14 i Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim:

"Çdo Shtet Palë që ka arsye të besojë se do të kryhet një vepër penale e parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater, në përputhje me të drejtën e tij kombëtare, do të japë sa më shpejt të jetë e mundur çdo informacion përkatës në zotërim të tij ndaj atyre shteteve që çmon se do të ishin shtetet që kanë vendosur juridiksionin në përputhje me nenin 6.".

Neni 14

Neni 15, paragrafi 3 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

"3. Informacioni i transmetuar, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, do të komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm për të gjitha Shtetet Palë, anëtarët e Organizatës, shtetet e tjera të interesuara dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare ndërqeveritare.".

Neni 15

Interpretimi dhe zbatimi

1. Konventa dhe ky Protokoll, si ndërmjet palëve të këtij Protokolli, do të lexohen dhe interpretohen së bashku si një instrument i vetëm.

2. Nenet 1 deri 16 të Konventës, të rishikuara nga ky Protokoll, së bashku me nenet 17 deri 24 të këtij Protokolli dhe shtojcën e saj, përbëjnë dhe emërtohen Konventa për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar 2005 (Konventa e SUA-së e vitit 2005).

Neni 16

Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 16bis i Konventës:

"Klauzolat përfundimtare të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar 2005

Klauzolat përfundimtare të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar të vitit 2005 janë nenet 17 deri 24 të Protokollit të vitit 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar. Referencat në këtë Konventë për Shtetet Palë do të nënkuptohen si referenca për Shtetet Palë të atij Protokolli.".

KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim në selinë e Organizatës nga data 14 shkurt 2006 deri më 13 shkurt 2007 dhe më pas do të mbetet i hapur për aderim.

2. Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u detyruar nga ky Protokoll, nga:

a) Nënshkrimi pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin; ose

b) Nënshkrimi që u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

c) Aderimi.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi kryhen me depozitimin e një instrumenti për këtë qëllim pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Vetëm një Shtet që ka nënshkruar Konventën pa rezerva për ratifikimin, pranimin ose miratimin ose ka ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në Konventë, mund të bëhet Palë e këtij Protokolli.

Neni 18

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës në të cilën dymbëdhjetë shtete e kanë nënshkruar atë pa rezerva për ratifikimin, pranimin ose miratimin ose kanë depozituar një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Për një shtet që depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, në lidhje me këtë Protokoll, pasi të jenë plotësuar kushtet për paragrafin 1 për hyrjen e tij në fuqi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, do të hyjnë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës së depozitimit të tillë.

Neni 19

Denoncimi

1. Ky Protokoll mund të denoncohet nga çdo Shtet Palë në çdo kohë pas datës në të cilën ky Protokoll hyn në fuqi për atë Shtet.

2. Denoncimi kryhet me depozitimin e një instrumenti denoncimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Një denoncim do të hyjë në fuqi një vit ose në një periudhë më të gjatë që mund të përcaktohet në instrumentin e denoncimit, pas depozitimit të instrumentit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 20
Rishikimi dhe ndryshimi

1. Konferenca, me qëllim të rishikimit ose të ndryshimit të këtij Protokolli, mund të thirret nga Organizata.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të thërrasë një konferencë të Shteteve Palë të këtij Protokolli për rishikimin ose ndryshimin e Protokollit, me kërkesën e një të tretës së Shteteve Palë ose dhjetë Shteteve Palë, cilado që është shifra më e lartë.

3. Çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i depozituar pas datës së hyrjes në fuqi të një amendimi të këtij protokolli do të konsiderohet se zbatohet në Protokoll, të ndryshuar.

Neni 21
Deklaratat

1. Pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një Shtet Palë që nuk është palë në një traktat të renditur në shtojcë mund të deklarojë që në zbatimin e këtij Protokolli për Palën Shtetërore, traktati konsiderohet të mos përfshihet në nenin 3ter. Deklarata pushon së qeni në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Shtetin Palë, i cili do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për këtë fakt.

2. Kur një Shtet Palë nuk është më palë në një traktat të renditur në shtojcë, mund të bëjë një deklaratë siç parashikohet në këtë nen, në lidhje me atë traktat.

3. Pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një Shtet Palë mund të deklarojë se do të zbatojë dispozitat e nenit 3ter, në përputhje me parimet e Së drejtës së tij penale në lidhje me përjashtimet familjare të përgjegjësisë.

Neni 22
Ndryshimet në shtojcë

1. Shtojca mund të ndryshohet me shtimin e traktateve përkatëse, që:

a) Janë të hapura për pjesëmarrjen e të gjitha shteteve;

b) Kanë hyrë në fuqi; dhe

c) Janë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar nga të paktën dymbëdhjetë Shtete Palë të këtij Protokolli.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, çdo Shtet Palë mund të propozojë një ndryshim të tillë në shtojcë. Çdo propozim për një ndryshim do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm në formë të shkruar. Sekretari i Përgjithshëm do të qarkullojë çdo amendament të propozuar që plotëson kërkesat e paragrafit 1 te të gjithë anëtarët e Organizatës dhe kërkon nga Shtetet Palë të këtij Protokolli pëlqimin e tyre për miratimin e amendimit të propozuar.

3. Amendimi i propozuar i shtojcës do të konsiderohet i miratuar pasi më shumë se dymbëdhjetë Shtete Palë të këtij Protokolli ta kenë miratuar me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Amendimi i miratuar i shtojcës do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të instrumentit të dymbëdhjetë të ratifikimit, pranimit ose miratimit të amendimit të tillë për ato Shtete Palë të këtij Protokolli që kanë depozituar një instrument të tillë. Për çdo Shtet Palë të këtij Protokolli që ratifikon, pranon ose miraton ndryshimin pas depozitimit të instrumentit të dymbëdhjetë pranë Sekretarit të Përgjithshëm, amendimi hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga një Shtet Anëtar i tillë të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 23
Depozitari

1. Ky Protokoll dhe çdo amendament i miratuar sipas neneve 20 dhe 22 do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të:

a) Informojë të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose kanë aderuar në këtë Protokoll:

i. secilin nënshkrim ose depozitim të ri të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, së bashku me datën e tij;

ii. datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli;

iii. depozitojë ndonjë instrument të denoncimit të këtij Protokolli, së bashku me datën në të cilën është pranuar dhe datën kur denoncimi hyn në fuqi;

iv. çdo komunikim të kërkuar nga ndonjë nen i këtij protokolli;

v. çdo propozim për ndryshimin e shtojcës që është bërë në përputhje me nenin 22, paragrafi 2;

vi. çdo amendament që konsiderohet të jetë miratuar në përputhje me nenin 22, paragrafi 3;

vii. çdo ndryshim i ratifikuar, pranuar ose miratuar në përputhje me nenin 22, paragrafi 4, së bashku me datën në të cilën ndryshimi do të hyjë në fuqi; dhe

b) Transmetojë kopje të vërtetuara të njësuara me origjinalin të këtij Protokolli për të gjitha shtetet që kanë nënshkruar ose aderuar në këtë Protokoll.

3. Në momentin e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, Sekretari i Përgjithshëm do të transmetojë një kopje të vërtetuar të njësuar me origjinalin te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 24
Gjuhët

Ky Protokoll është hartuar në një origjinal të vetëm në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëlloj autentik.

Bërë në Londër, në datën katërmbëdhjetë tetor dy mijë e pesë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

PROTOKOLLI I 2005-ës I PROTOKOLLIT PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË PLATFORMAVE FIKSE NË SHELFIN KONTINENTAL

Shtetet Palë të këtij Protokolli,

duke qenë palë të këtij Protokolli për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, të nënshkruar në Romë në datën 10 mars 1988;

duke pranuar se arsyet për të cilat Protokolli i vitit 2005 i Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar u shtjellua edhe për aplikimin për platformat fikse të vendosura në shelfin kontinental;

duke pasur parasysh dispozitat e atyre Protokolleve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllime të këtij Protokolli:

1. "Protokoll i vitit 1988" do të thotë Protokolli për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, i nënshkruar në Romë më 10 mars 1988.

2. "Organizatë" do të thotë Organizata Ndërkombëtare Detare.

3. "Sekretar i Përgjithshëm" do të thotë Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës.

Neni 2

Neni 1, paragrafi 1 i Protokollit të vitit 1988, është zëvendësuar nga teksti i mëposhtëm:

"1. Dispozitat e nenit 1, paragrafët 1(c), (d), (e), (f), (g), (h) dhe 2 (a) të neneve 2, 5, 7 dhe të neneve 10 deri te 16, duke përfshirë nenet 11, 12 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, të ndryshuar nga Protokolli i vitit 2005, i Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, do të zbatohen edhe për ndryshimet e nevojshme për veprat penale të përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokolli, kur vepra penale të tilla janë kryer në bord ose kundrejt platformave fikse në shelfin kontinental.".

Neni 3

1. Neni 2, paragrafi 1 (d) i Protokollit të 1988-ës, është zëvendësuar nga teksti i mëposhtëm:

"d) Vendos ose merr masa për vendosjen në një platformë fikse, me çdo mënyrë, të një pajisjeje ose substance, e cila mund ta shkatërrojë atë platformë fikse ose mund ta rrezikojë sigurinë e saj.".

2. Neni 2, paragrafi 1 (e) i Protokollit 1988, është zëvendësuar nga teksti i mëposhtëm:

"Gjithashtu, çdo person kryen një vepër penale nëse kërcënon, me ose pa kushte, siç parashikohet sipas ligjit, me qëllim detyrimin e një personi fizik ose juridik për të kryer ose jo ndonjë akt, për të kryer ndonjë prej veprave penale siç parashikohen në paragrafët 1 (b) dhe (c), nëse ai kërcënim mund të rrezikojë sigurinë e platformës fikse.".

Neni 4

1. Teksti i mëposhtëm është përfshirë si neni 2bis:

"Neni 2bis

Çdo person që kryen një vepër penale brenda kuptimit të këtij Protokolli, nëse ky person në mënyrë të paligjshme ose qëllimisht, kur qëllimi i aktit, nga natyra ose konteksti, është që të frikësojë popullsinë ose të detyrojë qeverinë ose një organizatë ndërkombëtare për të kryer ose jo një akt të caktuar:

a) Përdor kundrejt ose në një platformë fikse ose lëshon nga një platformë fikse lëndë eksplozive, materiale radioaktive ose armë të shkatërrimit në masë në një mënyrë që shkakton ose mund të shkaktojë vdekjen ose dëme serioze ose lëndime; ose

b) Lëshon nga një platformë fikse, vaj, gaz të lëngshëm ose substanca të tjera të dëmshme që nuk përfshihen në nënparagrafin (a), në sasi të tilla ose përqendrim që mund të shkaktojë vdekjen ose dëme ose lëndime; ose

c) Kërcënon, siç parashikohet me ligj, për të kryer një vepër penale, sipas nënparagrafët (a) ose (b).".

2. Teksti i mëposhtëm është përfshirë si neni 2ter:

"Neni 2ter

Një person kryen, gjithashtu, një vepër penale, nëse brenda kuptimit të këtij Protokolli:

a) Plagos ose vret qëllimisht dhe në mënyrë të paligjshme një person në lidhje me kryerjen e ndonjë prej veprave penale të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 1 ose neni 2 bis; ose

b) Tenton të kryejë një vepër penale të përcaktuar në nenin 2, paragrafi 1, neni 2 bis, nënparagrafët (a) ose (b) ose nënparagrafi (a) i këtij neni ose

c) Merr pjesë si bashkëfajtor në një vepër penale të përcaktuar në nenin 2, nenin 2 bis ose në nënparagrafët 9(a) ose (b) të këtij neni; ose

d) Organizon ose drejton të tjerët për të kryer një vepër penale të përcaktuar në nenin 2, neni 2 bis apo nënparagrafët (a) ose (b) të këtij neni; ose

e) Kontribuon në kryerjen e një ose më shumë veprave penaleve të përcaktuara në nenin 2, nenin 2 bis apo nënparagrafët (a) ose (b) të këtij neni, nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët, qëllimisht:

i. me qëllim vazhdimin e veprimtarisë kriminale apo qëllimit kriminal të grupit, ku veprimtaria apo qëllime të tilla përfshijnë kryerjen e një vepre penaleje të përcaktuar në nenin 2 apo 2bis; ose

ii. në dijeninë e qëllimit të grupit për të kryer një vepër penale të përcaktuar në nenin 2 ose nenin 2bis.".

Neni 5

1. Neni 3, paragrafi 1 i Protokollit 1988, është zëvendësuar me tekstin e mëposhtëm:

"1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale të përcaktuara në nenet 2, 2bis dhe 2ter kur kryhet vepra penale:

a) Kundër ose në bordin e një platforme fikse kur është e vendosur në Shelfin Kontinental të atij Shteti; ose

b) Nga një shtetas i atij Shteti.".

2. Neni 3, paragrafi 3 i Protokollit 1988 ,është zëvendësuar me tekstin e mëposhtëm:

"3. Çdo Shtet Palë, që ka vendosur juridiksionin e përmendur në paragrafin 2, duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm. Nëse ky Shtet Palë e revokon më vonë atë juridiksion, ai duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm.".

3. Neni 3, paragrafi 4 i Protokollit 1988, është zëvendësuar me tekstin e mëposhtëm:

"4. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale të përcaktuara në nenin 2, në rastet kur autori i dyshuar është i pranishëm në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë në ndonjë nga Shtetet Palë që kanë vendosur juridiksionin e tyre, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.".

Neni 6

Interpretimi dhe zbatimi

1. Protokolli i vitit 1988 dhe ky Protokoll, si ndërmjet Palëve të këtij Protokolli, duhet të lexohen dhe të interpretohen si një instrument i vetëm.

2. Nenet 1 deri 4 të këtij Protokolli, siç janë rishikuar nga ky Protokoll, bashkë me nenet 8 deri 13 të këtij Protokolli, duhet të caktohen dhe emërtohen "Protokolli për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse" të vendosura në Shelfin Kontinental 2005 (Protokolli për Platformat Fikse SUA, 2005 SUA).

Neni 7

Teksti i mëposhtëm është shtuar në nenin 4bis të Protokollit:

"Klauzolat përfundimtare të Protokollit të Ndalimit së Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental 2005

Klauzolat përfundimtare të Protokollit të Ndalimit së Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental 2005, duhet të jenë nenet 8 deri 13 të Protokollit të vitit 2005 për Protokollin e Ndalimit së Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental. Referencat e këtij Protokolli te Shtetet Palë duhet t'u referohen Shteteve Palë të Protokollit të vitit 2005.".

KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 8

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky Protokoll duhet të jetë i hapur për nënshkrim në zyrat qendrore të Organizatës, nga data 14 shkurt 2006 deri më 13 shkurt 2007 dhe duhet të mbetet i hapur për aderim.

2. Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u lidhur ligjërisht nga ky Protokoll, nga:

a) Nënshkrimi pa rezervë për ratifikim, pranim apo miratim; ose

b) Nënshkrimi i subjektit për ratifikim, pranim apo miratim, i pasuar nga ratifikimi, pranimi apo miratimi; ose

c) Aderimi.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të kryhen me depozitimin e një instrumenti për këtë qëllim te Sekretari i Përgjithshëm.

4. Vetëm një Shtet që ka nënshkruar Protokollin e vitit 1988, pa rezerva, për sa u përket ratifikimit, pranimit ose miratimit, ose ka ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në Protokollin e vitit 1988, mund të bëhet Palë e këtij Protokolli.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës në të cilën tri shtetet e kanë nënshkruar atë, pa rezerva, për ratifikimin, pranimin ose miratimin, ose kanë depozituar një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm. Megjithatë, ky Protokoll nuk hyn në fuqi para Protokollit të vitit 2005 të Konventës për Ndalimin e Veprave të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar.

2. Për një Shtet që depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, në lidhje me këtë Protokoll, pas përmbushjes së kushteve në paragrafin 1 për hyrje në fuqi të tij, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës së depozitimit.

Neni 10

Denoncimi

1. Ky Protokoll mund të denoncohet nga çdo Shtet Palë, në çdo kohë, pas datës kur ky Protokoll hyn në fuqi për atë shtet.

2. Denoncimi kryhet me depozitimin e një instrumenti denoncimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Një denoncim do të hyjë në fuqi një vit ose një periudhë më të gjatë, që mund të jetë e përcaktuar në instrumentin e denoncimit, pas depozitimit të instrumentit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 11

Rishikimi dhe ndryshimi

1. Një konferencë, me qëllim rishikimin ose ndryshimin e këtij Protokolli, mund të organizohet nga Organizata.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të thërrasë një konferencë të Shteteve Palë në këtë Protokoll për rishikimin ose ndryshimin e Protokollit, me kërkesën e një të tretës së Shteteve Palë ose pesë Shteteve Palë, cilido që është numri më i lartë.

3. Çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, i depozituar pas datës së hyrjes në fuqi të një amendamenti te ky Protokoll, do të konsiderohet të zbatohet si i ndryshuar.

Neni 12

Depozitari

1. Ky Protokoll dhe çdo amendament i miratuar, sipas nenit 11, do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm duhet:

a) Të informojë të gjitha shtetet që kanë

nënshkruar këtë Protokoll ose kanë aderuar në këtë Protokoll, për:

i. çdo nënshkrim të ri ose depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, së bashku me datën e tij;

ii. datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli;

iii. depozitimin e çdo instrumenti të denoncimit të këtij Protokolli, së bashku me datën në të cilën është marrë dhe datën kur denoncimi hyn në fuqi;

iv. çdo komunikim që kërkohet nga çdo nen i këtij protokolli; dhe

b) Të transmetojë kopje të vërtetuara të këtij Protokolli për të gjitha shtetet që kanë nënshkruar ose aderuar në këtë Protokoll.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, një kopje e vërtetuar e tekstit do të transmetohet nga Sekretari i Përgjithshëm te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, për regjistrim dhe publikim, në pajtim me nenin 102 të ligjit të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 13
Gjuhët

Ky Protokoll është hartuar në një origjinal të vetëm në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëlloj autentik.

Bërë në Londër, në datën katërmbëdhjetë tetor dy mijë e pesë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

KËRKESË
Nr. 10724/4, datë 7.11.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë, faza I", shtesa.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkohet që të vihen në dijeni personat të cilët preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë, faza I", për shpronësimin e pasurive të tyre, si dhe për masën e vlerësimit, të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 3 952 338 lekë (tre milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA E VLERËSIMIT PARAPRAK TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIM URBAN NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË, FAZA I", SHTESA

Nr	EMËR MBIEMËR	Zona Kad.	Nr. Pasurisë	Rrethi	Sip. e ndërtimit (m2)	Sip. e truallit (m2)	Çmimi i ndërtimit (l/m2)	Çmimi i truallit (l/m2)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera Totale (lekë)	KONFIRMIM NGA ZVRPP
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
1	Bashkëpronarët Çakërri, Koka, Kreshpaj dhe Alizoti	ZK. 8602	2/125	Vlorë	—	362.5	—	10,903	—	3,952,337.50	3,952,337.50	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, Pasuri e llojit "Truall".

VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT **3,952,337.50**

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë